



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Qershor 2009 • Viti XXVI • Nr. 6 (176) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3\$FR, SHBA \$2.50



Pse një “vit priftëror”?

FAQE 8-9

MONS.
GEORGE FREND O.P.



Shën Pali: apostulli i popujve

FAQE 10-11

Shkruan:
DON ALBERT DEMAJ

ABC-ja bashkëshortore – martesore (III)

FAQE 17

Shkruan:
P. SHTJEFËN DODES SJ



Shën Pali - ungjillëzuesi i popullit tonë

Fjala e Ipeshkvit mons. Dodë Gjergji në vigjiljen e Përmbylljes së vitit të shën Palit Apostullit

Fort të dashur vëllezër në Meshtari,
Motra të nderit,
vëllezër e motra në pagëzim
dhe ju të dashur miq,

Sot po mbushet plot një vit kur Papa Benedikti i XVI na ka ftuar të ripërtërijmë besimin tonë në përvojën e Shën Palit Apostullit të popujve dhe ungjillëzuesit tonë. Gjatë tërë këtij vitit kemi bërë takime të ndryshme shpirtërore, me klerin, me rregulltarët, rregulltaret, me bashkësitë tona famullitare. Kemi diskutuar me bashkëqytetarët nëpërmjet shtypit tonë dhe nëpërmes mjeteve të komunikimit publik. Më 10 qershor e kemi shtruar këtë temë në një Simpozium shkencor në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, nën përkujdesjen e Parlamentit të Kosovës, për çka jemi mirënjohës dhe të falënderueshëm. Mbi të gjitha kemi lutur dhe kemi falënderuar Zotin për dhuratën e madhe të fesë.

Pas një angazhimi të thellë shpirtëror dhe kulturor, ia sot kemi shtegtuar drejt kësaj kishe për të përmbyllur këtë Vit Jubilar dhe për të falënderuar Zotin tonë Jezu Krishtin, si dhe Kishën, “Nënë dhe Mësuens”, familjes së Zotit në tokë, për përtëritjen e fesë tonë në dritën e Ungjillit sipas përvojës apostolike të Shën Pjetrit e Palit.

Fort të dashur vëllezër e motra,

Shën Pali dhe shën Pjetri janë dy shtylla mbi të cilat ngrihet Kisha e Kishitit. Mbi Pjetrin ajo ndërtohet, pasi që ai është Shkëmb-Pjetër, mbi apostujt mbahet, sepse janë shtyllat kryesore, nëpërmjet shenjtërvës përthihet nën udhëheqjen e Shpirtit Shenjt. Shën Pali është ndërtesuesi më i zellshëm i saj në të gjitha kohërat. Ai i cili e urrente dhe e persekutonte Kishën, pasi e zbuloi Krishtin, arriti ta donte atë mbi gjithçka e më shumë se të gjithë, dhe t’ua shpallte Ungjillin – Lajmin e Gëzuar popujve të shumtë, mes të cilve edhe Ilirëve – paraardhësve tanë. Nëpërmjet tij ne jemi bërë Kishë Apostolike dhe popull biblik. Për këtë dua, së bashku me ju, sot të lartësoj nga zemra e Kishës tonë një lutje falënderimi Zotit për këtë dhuratë të madhe që na ka besuar – Shën Palin, nëpërmjet tij Krishtin dhe Kishën Katolike.

Janë plot dymijë vjet nga që shën Pali e hodhi këtë farë të mirë të Ungjillit, të Zotit tonë Jezu Krishtit në popullin tonë. E ne, qysh nga ajo kohë e deri më sot, e kemi ruajtur këtë fe në zemër, në familje dhe në popull me shumë përkushti dhe dashuri, me plotë fljime, martirizime dhe rreziqe, duke e trashëguar atë nga zemra e etërve në zemrat e bijëve dhe bijave, berz pas brezi, deri në ditët tona. Është mirë që të ripërtërijmë dhe ta rishkrujmë në zemrat dhe mendjet tona këtë porosi ungjillore, në mënyrë që mos ta mbajmë vetëm si një pasuri që e kemi trashëguar, por të mbindëtojmë duke e shëndrruar në përcaktim dhe jetësim si zgjidhje personale dhe dëshmi jetësore të kësaj dhurate hyjnore.

Duke e jetuar këtë Porosi me besnikëri dhe duke e shpallur me dashuri, sepse shpallja dhe dëshmia e Krishtit të kryqëzuar nën ndikimin e Shpirtit Shenjt, është gjithnjë vepër e Zotit dhe bashkëpunimi ynë me birin e tij. Mu për këtë Zoti këtë vepër e kryen nëpërmjet njerëzve që i ka zgjedhur dhe i ka dërguar, si Shën Palin dikur, apo të Lumen Nënë Tereze në ditët tona.

Edhe ne si generatat e mëparshme, do të jemi të vendosur t’i



Shën Pali dhe fillimet e krishterimit në trojet e sotme të shqiptarëve

FAQE 14

Shkruan:
Aleksandër MEKSI

Intervistë me artistën Shkurte Fejza në 10 vjetorin e lirisë së Kosovës

Kënga ime është Kosova

FAQE 12-13



(vijuar nga ballina)

marrim përgjegjësitë tona që burojnë nga Ungjilli i Krishtit dhe pagëzimi. Kështu do të dëshmojmë se, angazhimi ynë për fenë, nuk buron vetëm nga ndjenja konservatore për të ruajtur diçka të vjetër, por për të riprodhuar shpresë dhe dashuri për veten tonë, për familjet tona dhe për popullin tonë.

Ne e dimë të gjithë se Kisha Katolike në të kaluarën është përpjekur me shumë flajime për të ruajtur identitetin tonë shpirtëror, kulturor, gjuhësor, kombëtar, si burimi kryesor i vlerave tona të përbashkëta dhe si kultivuese e fuqishme e begatave tona shqiptare. Thënë figurativisht Kisha jonë ishte "nyja e pazgjidhur" në fijen e së kaluarës sonë, që na ka mbajtur të pashkëputur nga qytetërimi i së Vërtetës dhe Dashurisë, parakusht ky për zhvillim në liri dhe në drejtësi, në përparim dhe në qytetërim të bashku me popujt e tjerë, ku ne po synojmë të bëhemi antarë dhe pjesëmarrës.

Falë zgjimit të vetëdijes kombëtare të rilindasve e me tutje, falë shkollimit dhe arsimimit masivë të popullit gjatë shekullit të fundit, si dhe lirisë që po e gëzojmë sot: të gjitha këto përgjegjësi që ne i ruanim me fanatizëm në gjirin e Kishës, kanë kaluar në përgjegjësinë e institucioneve përkatëse të cilat burojnë nga përparimi ynë.

Në historinë më të re, sidomos të dhjetë viteve të fundit, ne po hetojmë dukuri të rrezikshme të cilat po i kanosen të ardhmës tonë, ndoshta edhe më të rrezikshme se në të kaluarën. Atëherë dihej se rreziku ynë ishin të tjerët, por sot ne rrezikojmë vetveten me dukuri tejet negative. Shtrohet pyetja: kush do të na

mbrojnë nga vetja jonë?

Sot është rrezikuar individi, sepse gjendet para shumë sfidave dhe zgjidhjeve, dhe fatqësisht, në shumicën e rasteve, përcaktohet për kinse më të "lehtë" apo më të "pëlqyeshmen", kështu që shumë të rinjë tanë kanë filluar të konsumojnë drogën, apo vajzat tona janë bërë "mall - pazari" për trafikimin dhe keqpërdorimin e njerëzve. Personat e tillë, nuk dëshirojmë t'i sulmojmë dhe fajësojmë, por dëshirojmë t'i vetëdijësojmë se gjenden në rrugë të keqe, dhe rrezikojnë veten dhe të tjerët. Kisha Katolike dëshiron t'u afrohet si mbështetje e fuqishme në rrugën e kthimit dhe shërimin të tyre.

Sot është në rrezik familja - e cila po përjeton thyerje të brendshme mes gjeneratave dhe nuk ka më gjuhë të përbashkët të bisedimit, dialogut dhe komunikimit ndërmjetor, duke rrezikuar dashurinë dhe harmoninë, gëzimin dhe jetën familjare. Sidomos kur të rinjtë dëshirojnë t'i bindin prindërit se, s'dinë asgjë, ose kur prindërit duke mos u besuar të rinjëve, mendojnë se ata do të rrënojnë gjithçka që me mund kanë ndërtuar. Kisha jonë dëshiron t'i ofrojë familjes së sotme frymëzimin ungjillor të dashurisë për njëri-tjetrin dhe nëpërmjet këshillave përkatëse të ndërmjetësorë mes brezeve, kështu që e vjetra të ruhet, por, ajo mos të pengojë rininë në përpjekjen e tyre për ta ndërtuar të ardhmen e vet.

Në rrezik është kombi - ne mburrëmi se jemi populli më i ri në Evropë, por "kolera e bardhë" - aborti, shkurorëzimet e familjeve të reja, dëshira për të pasur një ose dy fëmijë, shumë shpejt do ta mplaquin edhe popullin tonë. Kur dikur jetonim në varfëri, kur kishim dy pëlla-

mbë shtëpi, kishim sofrën plot me fëmijë, e tani: sa më t' mira po i bëjmë shpiat, aq më pak të bijtë dhe të bijat. Kisha i gëzohet thvillimit dhe përparimit material dhe shoqëror, por thekson gjithnjë jeta është pasuria më e madhe e kombit dhe mbarë njerëzimit, dhe kur ajo mungon, s'ka më asgjë.

Kjo që ne po pohojmë, nuk buron nga dëshira për të akuzuar shoqërinë, por nga kujdesi dhe dashuria për të. Njëkohësisht dëshirojmë të theksojmë se këto janë sfidat tona të përbashkëta, në të cilat Kisha dëshiron të përqëndrojë veprën e saj në të ardhmen.

Vëllezër dhe motra, këtë përvojë shpirtërore në fe, në Kishë dhe në dashuri, e kemi bashkë-ndarë me të gjithë bashkëkombasit tanë gjatë së kaluarës tonë të lashtë, së paku gjatë XVI shekujve, me disa bile edhe më shumë e, me njëri-tjetrin deri sot. Është e vërtetë që një pjesë e madhe e jona është ndarë nga përvoja e përbashkët në fe, por kurrë nuk është ndarë apo shkëputur tërësisht nga përvoja në dashuri dhe nga vetëdija se jemi vëllezër.

Sa e dëgjuam ishte ndarja, aq e begatshme ishte përvoja e dashurisë për njëri-tjetrin, përvojë kjo që është unike dhe nuk mund të gjendet në asnjë komb tjetër. Deri vonë kemi patur shembullin e bashkëjetesës ndërfaqetare në të njëjtën famillje, kur njëri vëlla kalonte në një përcaktim të ri fetar, e tjetri vazhdonte t'i mbetej besnik fesë së vjetër. Kuri i gjithë fisi ndryshonte përcaktimin fetar, por vazhdonte të ruante kujtesën e përvojës së mëparshme dhe dashurinë për atë që braktisnin. Kjo mosheqe dorë tërisht nga përvoja e mëparshme shpirtërore, si dhe vazhdimësia e të qenit vëllezër, është fenomen unik dhe shembull i përkryer për këdo. Në sa familje tona janë ende gjallë pleqtë, që kujtojnë se si më parë ushtronin përvojën e krishterë në familjet e tyre, dhe këtë dëshmi ua transmetojnë nipave të tyre; në sa fshatra apo vende, ku sot nuk jemi të pranishëm, kemi ende: Ara e priftit, Kodra e kishës, Kronin e fratit e shembuj të shumtë të tjerë, që dëshmojnë se ndër ne nuk kishte asnjëherë tendencë të mosdimitit fetar me njëri-tjetrin? Dhe jo vetëm kaq, por ne që i mbetëm besnikë Krishtit dhe Kishës, asnjëherë nuk kemi hequr dorë nga vëllezërit tanë që shpirtërisht u ndanë prej nesh. Në anën tjetër as ata s'kanë hequr dorë kurrë nga fakti që na kanë vëllezër. Kjo historikisht ishte një ligësi jona, por ja që, e kaluara na mëson se ligështia u shëndrrua në forcë me të cilën ne kemi arritur t'i tejkalojmë të gjitha vështirësitë, vuajtjet dhe trishtimet e të së kaluarës dhe t'i

bëjmë ballë vëllazërisht çdo rreziku që i kanosej popullit, kulturës dhe traditës tonë.

Mu në këto përvoja e vlera i ka rrënjët edhe toleranca fetare ndër ne. Sot, si të krishterët ashtu edhe jo të krishterët, si ata që janë në kërkim të një përcaktimit të ri shpirtëror, ashtu edhe ata që i kanë braktisur të dyjat: çmojmë tolerancën fetare si pasurinë më të çmueshme që kemi. Këtë pasuri nuk guxon ta prishë askush, aq më tepër, gjithë jemi të thirrur ta begatojmë atë me dashuri për njëri-tjetrin, me përpjekje të përbashkëta për t'u përballur me sfidat e reja që po na afrojnë sotmja dhe me angazhim të palodhshëm për të ndërtuar një të ardhme më fatlume për fëmijët tanë, për familjet tona, për popullin tonë dhe për të gjithë të tjerët që jetojnë në Kosovë, me të cilët bashkëndajmë të sotmën e po përgatitemi ta ndajmë edhe të nesërmen.

Vëllezër e motra fort të dashur, e kaluara jonë është Mësuesja me e mira nga e cila duhet të mësojmë të gjithë. Ne në të vërtetë kemi vuatur shumë, por kemi qëndruar të pathyeshëm në atë që kemi qenë dhe në atë që jemi. Sot duke falënderuar Zotin, flajmin tonë, si dhe mbështetjen e miqve, po gëzojmë lirinë që nuk e kemi pasur kurrë më parë. Sot të gjithë mund të konkurojmë me vlerat dhe me virtytet tona të mirëfillëta. Sot të gjithë mund të investojmë kapacitetet tona në doli të njëri-tjetrit. Sot secili mund të përcaktohet lirisht në atë që mendon se është e mira e tij. Mbi të gjitha, është hera e parë në historinë tonë, kur secilit i lejohet zgjidhja personale e përcaktimit fetar. A nuk është kjo kohë e shejtë për gjithë ne, kur nga zemra e lirë dhe pa kërcnim të jashtëm mund t'i drejtojmë lutjet tona Zotit?

Falënderoj Zotin që sot në mesin tonë kemi edhe të pagëzuarit e ri, të cilët falë lirisë që po e gëzojmë, janë kthye Kishës dhe fesë së tyre të mëparshme. Të dashur në Krishtin, juve ju pranojmë me gëzimin ungjillor të shembullit të Babës së Mirë, i cili priste djalën e humbur, me dashurinë me të cilën Shën Pali ia predikonte Krishtin botës së atëherëshme. Ju jeni kthye në shtëpinë tuaj shpirtërore dhe në përvojën tuaj të mëparshme. Në ju po rikthehet përvoja e mëparshme e bashkëjetesës ndërfaqetare brenda një familjeje. Ju nëpërmjet pagëzimit, jeni rrethuar për të qenë të bijtë e Zotit- Dashuri. Prandaj, ju ftoj të jeni bartës të kësaj dashurie të gjithë njerëzit. Këtë do të dëshmoni nëse do të arrini t'i doni të afërmit tuaj edhe njëqind herë më shumë se i keni dashur deri më tani, t'i doni me gjithë zemër ata që nuk pajtohen me

vendimin tuaj, dhe me veprën e dashurisë ndaj tyre, të dëshmoni se zgjidhja juaj ka qenë e mirë jo vetëm për ju, por për të gjithë, sepse dashuria është nevoja më e madhe për çdo njeri. Duani ata që ndoshta ju urrejnë, mu ashtu siç i donte Krishti ata që e kryqëzonin.

Posaçërisht dëshiroj të ju drejtoj një fjalë, besimtarëve tonë nga Janjeva: Ju jeni pasuria jonë, ne jemi mbështetja juaj.

Vëllezër, ju jeni me nacionalitetet kroat, por ju e dini nga përvoja e Kishës se feja nuk kërcënon dhe nuk i asgjëson kombin, gjuhën, traditën, por i bashkon kombet në vlerat të përbashkëta dhe në qytetërimet përparimtare. Ju duhet t'i ruani vlerat e juaja, gjuhën tuaj dhe traditat tuaja, ashtu siç i kemi ruajtur ne shqiptarët tonat.

Një pjesë e madhe e kombit është shpërndarë në shumë vendet e botës, ka shumë edhe të tillë që planifikojnë edhe sot të mërgojnë. Ne i ftojme ata që moti janë larguar që me kujdes të shqyrtojnë mundësinë e kthimit, e atë që planifikojnë të shkojnë, i ftojme të heqin dorë nga kafshata e hidhtë të mërgimit dhe të punojnë për të ndërtuar të ardhmen në vendlindje. Askund nuk është lehtë të jetohej, jeta është përballje me flajime dhe vuajtje, por kjo mundësi duhet shfrytëzuar vëllazërisht dhe bashkarisht, me ndihmën e Zotit dhe përkrashjen e njëri-tjetrit.

Të dashur vëllezër, Kisha katolike gjithmonë ka qenë në doli të të gjithëve, si në përndjekje dhe në martirizime, po ashtu edhe në liri, duke e ruajtur vazhdimisht të drejtën të shpallim Ungjillin, të dëshmojmë Krishtin, të ndërtojmë Kishën, të jetojmë fenë, të kujdeset për të shtypurit, të vegjëlit dhe të mjerët. Kjo është e drejtë themelore, që buron nga detyrimi hynor dhe udhëzimi ungjillor.

Nëse ne e shpallim guximisht Krishtin dhe Ungjillin e tij, nuk domethënë se dëshirojmë t'i imponohemi dikuj, ose ta detyrojmë dikë që të besojë si ne, por "shtrojmë" një sofrë vëllazërore në të cilën të gjithë janë të ftuar t'i vejnë vlerat dhe virtytet e veta.

Nëse e dëshmojmë këtë me jetë dhe me veprimtari, atëherë dëshmia jonë është shprehje dashurie ndaj të gjithëve, dëshmi falje për të gjithë, dëshmi kujdesi për të tjerët, dëshmi flajimi dhe dhurim në të mirë dhe në doli të të gjithëve.

Kjo është rruga e Jezu Krishtit, e Shën Palit, e së Lumes Nënës Tereze, e të parëve tanë gjatë dy mijë vjetëve të krishtetimit. Ky është përcaktimi ynë sot dhe gjithnjë!



Mons. Dodë Gjergji gjatë prodikimit në Gjakovë

Shtegtimi i Kishës sonë vendore në Letnicë

Më mot të ftohtë, por me zemër të nxehtë, pranë Zojës Cërnağore

Më mot të ftohtë, por me zemër të nxehtë, pranë Zojës Cërnağore janë fjalët që ndoshta mund ta përmbledhin më së miri atmosferën e shtegtimt të kishës sonë lokale në shenjtëroren e Zojës Cërnağore në Letnicë. Tashmë është bërë më së tradicional ky shtegtim i ipeshkvisë sonë në të shtunën e fundit të muajit maj. Në këtë vit, pikërisht të shtunën,

shkak të motit. Mesha ishte kulmi dhe pikë-qëllimi i gjithë këtij shtegtimi. Mesha filloi rreth orës 11:00, të cilën e udhëhoqi ipeshkvi i Administraturës Apostolike të Prizrenit, Mons Dodë Gjergji, në bashkë-meshim me shumicën e meshtarëve të kishës sonë. Ishte vërtet një gëzim i madh të vërsh aq meshtar të bashkuar me ipeshkvin e tyre dhe me një



me 30 maj nga mbarë Administratura Apostolike e Prizreni, të gjitha famullitë, pra, të organizuara së bashku me meshtarët e vet me autobus, por edhe në mënyrë individuale dhe familjare, u tubuan për të përfunduar muajin e kushtuar Zojës së Bekuar, Nënës sonë qiellore.

Muaji maj është më i bukur i vitit, është muaji i dytë i stinës më të bukur, pranverës. Është muaji që frymëzon poetë, shkrimtarë, e predikatarë. Është muaji që sjell gëzim dhe hare në zemrat e njerëzve. E sidomos është muaji i kushtuar Zojës së Bekuar, nënës së Krishtit dhe nënës së të gjithë neve. Për këtë arsye në shumë famulli e sidomos në Prizren, Velezhë edhe në famullitë e tjera gjatë këtij muaji hasim një devocion ndaj Zojës së Bekuar, ku për çdo ditë lutet rruarja e shenjtë, litanitë e Zojës, mesha e shenjtë me predikim, me një pjesëmarrje të mirë të besimtarëve që gati po thuajse u ngjajnë vajtes zakonshe të të dielave. Gjithë këtij devocioni dhe kësaj dashurie dhe nderi që i bëhet Zojës së Bekuar, tashmë është bërë traditë që për çdo vit ky muaj i Zojës të përmbillet me një shtegtim të përbashkët të mbarë kishës sonë vendore.

Për dallim prej viteve të kaluara, në këtë vit koha atmosferike nuk ishte në favor të shtegtarëve, sepse mbajti një kohë e ftohtë dhe me shi. Meqenëse tashmë ishim mësuar me të ngrohtit e stinës pranverore, besimtarët nuk ishin aspak të përgatitur për ta përballuar këtë freski që na befaso i të gjithëve. Megjithatë, klima atmosferike nuk qe pengesë për zhvillimin dhe realizimin e mirë dhe të suksesshëm të këtij shtegtimi. Shtegtimi filloi me arritjen e shtegtarëve në Letnicë rreth orës 10:00 edhe pse disa me vështirësi për

numër të konsiderueshëm të besimtarëve. Për të gjithë që gëzim i madh. Ipeshkvi, mons. Dodë Gjergji, në grishjen e tij të rastit, shprehi gjithë gëzimin e kishës për fenë dhe devocionin që besimtarët vazhdimisht tregojnë gjatë tërë vitit, por në veçanësi gjatë këtij muaji të majit. Ai theksoi edhe faktin e heroizmit të shumë gjeneratave që me plotë zell ruajtën kombin, fenë dhe kulturën duke mos kursyer edhe në të shtrenjtën jetën e tyre. Pra brezat e kaluara janë shembull për rininë sot, se si duhet të ruhet dhe të jetohet feja, theksoi me plot zemër ipeshkvi ynë mons. Dodë Gjergji. Besimtarët dhe të gjithë të pranishmit me gëzim i pranuan fjalët drejtuese të ipeshkvit dhe ju gëzuan këtij takimi të dyfishtë me Zotin dhe me njëri tjetrin.

Mesha u shoqërua nga Kori i famullisë së "Shën Jozefit" në Stubëll, të drejtuar nga motra Zoje Përlaska. Kori ishte edhe ndihmë që edhe asambleja e besimtarëve të mund të merrte sa më mirë pjesë në kremtimin liturgjik. Pasi që moti ishte jo aq i mirë, siç theksuam edhe më parë, atëherë pas meshe të gjithë shtegtarëve ju dha mundësia që të ndalën dhe të drekojnë, të bëjnë një lloji pick-nicku dhe diku rreth orës 15:00 gati të gjitha famullitë morën rrugën e kthimit për në shtëpitë e veta. E mirë dhe e veçantë ishte edhe atmosfera nëpër autobus, më lutje, uratë dhe shkëmbime bisedash besimtarët dhe të rinjtë e pasuruan njëri tjetrin. Dhashtë i madhi Zot që edhe në të ardhmen të ketë edhe me shumë takime të mira që i ndihmojnë bashkimin me Zotin dhe me njëri-tjetrin. Mirë u pafshim në takimet e radhës!

(Dritapress)

U kremtua festa e Shna Ndout në Gjakovë

Të premten, më 12. qershor – Natën e festës së shën Antonit Meshën kremtoi don Dominik Qerimi, meshtar salezian nga Tirana.

Të shtunën, më 13 qershor, – Ditën e shën Antonit meshën e parë e celebroi patër Ndue Kaj-tazi

Meshën e madhe, në orën 11 e udhëhoqi patër Franë Dushi, frati nga Kuvendi Françeskan i Tuzit.

Patër Frani foli për jetën e shën Andout dhe theksin e vendosi mbi katër shembuj që të kuptohet më mirë porosia që kishte për ta thënë.

1) Shën Andou ju ndihmon njerëzve në nevojë, ashtu sikur i kishte ndihmuar edhe vet predikatarit kur ishte shumë i sëmurë.

2) Duke vënë theksin mbi rëndësinë e edukimit të fëmijëve tregoi një rast kur djali ishte hidhëruar keq në prindin e vet, sepse ai nuk e kishte edukuar sa ishte ende i ri.

3) Duke folur për të ardhmen e Evropës tregoi një rast kur një françeskan plak kishte dalur të



shetiste në një shetitore të Dubrovnikut, dhe i kishte parë të rinjtë gati të çveshur, dhe ishte trishtuar për të ardhmen që na pret nëse nuk do t'i ruajmë vlerat tona kombëtare e fetare.

4) Shembulli i fundi ishte me një vajzë nga Kosova që frati e kishte takuar në Megjugorje, ku atje ajo kishte shkuar të shërohet nga droga. Kjo vajzë kishte treguar historinë e vet të mjerëse shpirtin e saj askush nuk

e kishte ushqyer me Zotin, por vetëm me gjëra të kësaj botë, e ajo kishte përfunduar keq.

Ushqeni shpirtin e fëmijëve tuaj më shpresë, fe e dashuri, me këto tri virtyte hyjnore, porositi në fund patër Frani. Për edukim të mirë e ardhmëri të ndritshme duhet në Kosovë të hapen shkolla e fakultete katolike, sepse ato janë garancia më e mirë e edukimit të shëndoshë.

(Dritapress)


U kremtua festa e Shna Ndout në Prishtinë

Në këtë ditë të bukur me diell të qershorit, shtegtarët e shumtë vërsuan Kishën në kryeqendër në Prishtinë. Kisha ishte tejet e vogël për t'i pranuar të gjithë besimtarët që nderonin shën Antonin, por ishin edhe në hapësirat rreth kishës, njerëzit vullnetmirë për të nderuar dhe falënderuar shën Antonin, që e nderon po thuajse mbarë bota...

Mesha solemne ishte në orën 11.00 të cilën e udhëhoqi don Viktor SOPI, famullitar në Ferizaj dhe drejtor i CARITASIT TË KOSOVËS. Vërtet ishte një ditë për ta falënderuar Zotin. Ditë plot gëzim, hare dhe shpresë kudo që vërehet në fytyrat e pjesëmarrësve aq më tepër që një numër i madh i tyre ishin studentë dhe rinia jonë shpresëdhënëse.

Në pretkun e rastit don Viktori ndër të tjerat theksoi: Nuk mjafton të njohim jetën dhe veprën madhore të shën Antonit por atë ta duam dhe ta dëshmojmë në jetën, në përditshmëri... nuk jemi dhe s'ka të përkryer në këtë tokë konsumuese, por njeriu që e do Zotin gjithnjë do të ngrihet pas lëshimit të mëkatit duke mos u pajtuar me të si shkëputje nga prezenca e Zotit në jetën tonë... sepse nuk është tragjike të gabosh, por të pajtohesh me mëkat kur ai bëhet gjendje, stil i jetës që e jeton duke mos pasur ndjenja për përgjegjësinë që kemi ndaj të afërmit... dhe normave, virtyeteve ku Zoti është prezent... çfarë ishte në jetën dhe veprën e shën Antonit.

Dhe vazhdoi: në të gjithë dëshirojmë progres... Progresi nën-



kupton shumë gjëra për njerëzit në botë. Për disa nënkuptohet si largim nga uria, nga varfëria, nga sëmundjet, nga lëndimet e ndryshme, vetmia, injoranca. Për të tjerët nënkupton shkëmbimin e tërësishëm të gjërave të mira për civilizimin. Por unë apeloj që progresi të kuptohet duke i shikuar më qartë gjërat që e bëjnë në jetën vërtet më humane e ato janë gjërat që e fisnikërojnë njeriun në vetvete, në brendinë e tij... gjërat shpirtërore që nuk mund t'i jep toka si konsum, sepse krejt çka jep toka, toka e merr.

Të rinjë dëshiroj t'iu qes në zemrat tuaja këtë porosi, që mos të pajtoheni me rënie në mëkat, i cili është shkëputje nga Zoti,

por luftojeni të keqen në zemrat dhe jetën tuaj, që mos të mbi-zotërojnë mendimin, zemrën tuaj prija e epsheve, mishit dhe gjakut, Do të gjeni forcë, nëse keni norma në jetë për të cilat do të sakrifikonit krejt çka është konsumuese... vetëm ai që ka kohë për uratë, lutje do të dijë të jetojë sipas vullnetit të Hyjit... Nëse në jetën e njeriut s'ka vend ZOTI, ajo jetë është e predestinuar për vuajtje, vetmi dhe dështim!

Në mbarim don Lekë Oroshi famullitar, falënderoi don Viktorin dhe i ftoi besimtarët që të meditojnë dhe shtien në veprim porosinë e prektuar...

(Dritapress)

U kremtua festa e Shna Ndout në Binçë

Në gjithësi ka disa planete, por neve më shumë se të tjerët na pëlqen dielli. Kështu edhe në Kishën tonë ka shumë shenjtër e shenjtëresha të Hyjit, të cilët me jetën dhe veprimtarinë e tyre i pëlqen Zotit dhe njerëzve. Mirëpo për besimtarët anekënd planetit, e sidomos për popullin tonë shqiptar, pa dyshim më i dashuri është Shën Antoni. Sot ne kemi ardhur këtu që me miliona besimtarë që sot vërshojnë kishat e shenjtëroret e shna Nout, për të nderuar dhe për t'u lutur këtij shenjtë mrekullibërës. Kështu e filloi predikimin e vet Don Ambroz Demaj, meshtarë i Stullës, i cili shërben në ipeshkvin e Krëshenit në Shqipëri. Në vazhdim tha: Nuk është i rastësishëm fakti se mu në ditën e sotme, para ro viteve

forcat serbe u larguan nga famullia juaj, pa iu dëmtuar juve, edhe pse me dëme materiale. A nuk është kjo një mrekulli e Pajtorit tuaj? Ai sot na thërret që lirinë të fituar me shumë sakrificë ta ruajmë, kultivojmë e zhvillojmë duke jetuar në paqe e dashuri me Zotin dhe të tjerët, duke ruajtur familjet tona nga veset e këqija, duke iu ndihmuar të rinjve që mos të robërohen nga veset negative.

Lë të theksojmë se besimtarët e famullisë së Binçës me treditësh e me përshpirtëri tjerë u përgatitën për festën e shna Ndout, e cila u kremtua në një atmosferë solemne, me pjesëmarrjen e shumë besimtarëve të ardhur nga famullitë për rreth.

(Dritapress)

U kremtua festa e Shna Ndout në Glllogjan

E dhe në famullinë e Glllogjanit, në territorin e Lugut të Baranit, u kremtua festa e Shën Ndout, që është pajtor i kësaj famullie dhe që njehëreshë të gjithë po thuajse edhe e festojnë si festë familjare. Si çdo vjet, edhe në kësaj radhe, festa e Shën Ndout bashkoi shumë besimtarë dhe njerëz të devotshëm. Mesha kryesore u kremtua në ora 11:00 dhe e kremtoi don Pal Tunaj, vikar i famullisë së Klinës. Ai në fjalën e predikimit foli për jetën

dhe veprën e Shën Andout dhe i ftoi besimtarët që të ndjekin rrugën e shenjtërisë që është thirrja e pashmangshme e secilit besimtar që është pagëzuar në Krishtin. Ndërsa në ora 9 mesheën e udhëhoqi don Kelmend Spaqi, ish famullitar i Glllogjanit. Edhe kjo ditë ishte gëzim dhe shkak hareje për të gjithë e në veçanti për të devotshmit e Shën Andout.

(Dritapress)

U mbajt panairi i XI i librit në Prishtinë

Për dallim nga vitet tjera, në këtë vit, e pranishme edhe shtëpia botuese "Drita"

Prej datës 3 deri më 7 qershor 2009, është mbajtur në Prishtinë, në Pallatin e rinisë, panairi XI, i organizuar nga shoqatat e botuesve të Kosovës dhe i mbështetur drejt përse drejt nga presidenti i vendit dr. Fatmir Sejdiu. Në këtë panair morën pjesë më shumë se njëqind shtëpia botuese nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, nga mbarë rajoni dhe më gjerë. Panairin e hapoi pikërisht më 3 qershor 2009, në ora 17, presidenti Fatmir Sejdiu bashkë me përfaqësuesin e shoqatës së botuesve, z. Nazmi Rrahmanin. Të pranishëm në këtë hapje solemne ishin edhe shumë figura të spikatura të institucione shtetërore, fetare dhe civile.

Ajo që, për ne se paku, e bënte të veçantë këtë panair ishte padyshim prania e shtëpisë botuese "DRITA", e cila ishte e vendosur pranë shtëpive tjera botuese me stendën e vet. Këtë e punë e realizoi Drejtori i shtëpisë botuese "Drita" dhe kryeredaktori i revistës "Drita", dr. don Lush Gjergji së bashku me dy bashkëpunëtorët e tij don Jeton Thaqin dhe don Anton Ukaj. Kjo punë do të ishte e pamundur ndoshta pa ndihmën e të rinjve që u angazhuan në menaxhimin e kësaj stende. Po i përmendim vetëm disa që me orë të tëra punuan në stendën e "Dritës": Vilson Culaj,



Luz Balaj, Antoneta Shtufi, Bergita Orosi, Aleksandër Veseli, Ardan Spaqi dhe Marin Pergjoka. Puna e tyre ishte shumë me vlerë, sepse me qëndrimin e tyre pranë kësaj stende ata dëshmonin qartë edhe identitetin e tyre fetar dhe kombëtar.

Së bashku me librat dhe botimet e "Dritës", ishin të pranishëm edhe botimet e kuvendit françeskan të Gjakovës dhe ato shtëpisë botuese "Shpresa". Por e rëndësishme është padyshim që kjo stendë u vizitua dhe u mirëprit nga shumë vizitor dhe dashamirë të librit me vlerë. Këtë panair dhe stendën tonë e vizitoi edhe ipeshkvi ynë mons Dodë Gjergji dhe shumë meshtarë e besimtarë të Administratursë Apostolike të Prizreni. Ndër lib-

rat më të shitur dhe më të kërkuar në këtë rast ishin: Bibla, Fjalori biblik, Monografia e don Lush Gjergjit mbi Nënë tonë Terezë, Krishterimi ndër shqiptarë i dr. Zef Mirdita, Islamizimi i shqiptarëve në shekuj - i autorit don Shan Zefi dhe libra të tjerë. Edhe kjo përvojë ishte e mirë, frytdhënëse dhe një dëshmi e vogël e para një opinionimi më të gjerë. Shpresojmë që edhe në të ardhmen prania e Dritës të jetë edhe më e pasur me tituj e me botime të reja. Urojmë që së bashku me dashamirët e librit të shihemi në panairin XII në vitin 2010 e pse jo edhe në panairin e tjera të rajonit.

(Dritapress)

U kremtua festa e shën Gjon Pagëzuesit në Zllakuqan

"Gëzojuni sukseseve dhe të mirave të tjerëve" - Don Lush Gjergji

Më 24 qershor, famullia e Zllakuqanit kremtoi festën e Shën Gjon Pagëzuesit dhe siç është traditë në këtë famullitë kjo ditë u paraprij nga tre ditësh, ku besimtarët me pjesëmarrjen e tyre në meshe dhe lutje patën rastin të përgatiten shpirtërisht për një kremtim sa më të denjë të kësaj feste. Duke pasur parasysh që ky është viti i parë i don Izak Dodës si famullitar i ri i famullisë së Zllakuqanit, ai se bashku me besimtarët e famullisë, të rinjtë dhe korin u angazhuan maksimalisht që kjo ditë të festohet ashtu siç i ka hije dhe gjithmonë e ka kremtuar famullia e Zllakuqanit.

Për ta bërë edhe me të madhërisme këtë festë, mesheën e udhëhoqi don Lush Gjergji, famullitar i katedrales së Prizrenit i shoqëruar edhe nga meshtar të famullive tjera.

Në meshe mori pjesë një numër i madh i besimtarëve edhe nga famullitë tjera ku, edhe pse ishte një ditë me shi, kjo nuk i pengoi ata që me praninë e tyre ta rrisin edhe me shumë gëzim dhe kësaj dite.

Gjatë predikimit don Lush



Gjergji na kujtoi edhe një herë se kush jemi, sa e rëndësishme është feja që ne i përkasim, sa na bënë të jemi krenar e në të njëjtën kohë të dimë të jemi të përvujtësëm, të dimë ta dëshmojmë fenë me shembuj e me vepra duke ju gëzuar suksessit dhe të mirave të tjerëve. Pastaj mesha vazhdoi me ritmin e zakonshëm dhe në momentin e shkëmbimit

të pages Don Lushi, prapë na bëri të mendojmë që shkëmbimi i pages të mos mbetet vetëm një rit por që me zemër dhe vetëdije, të pajtuar me Zotin ta përcjellim pagën të njeri tjetri.

Në fund të meshës, Don Izak falënderoi dhe ju uroi festën e Shën Gjon Pagëzuesit të gjithë besimtarëve.

(Leonora Gajani)

Festa e Zemrës së Krishtit në Viti dhe Jagodë

Më 19 qershor të këtij viti në dy filialet e Administratursë Apostolike të Prizrenit, kryesisht në Viti dhe Jagodë, u kremtua me solemnitë shumë të madh festa e zemrës së Krishtit. Festimi qendror me praninë e shumicës së meshtarëve u bë në Viti, në filialin e famullisë së Binçës, ku mesheën kryesore e udhëhoqi ipeshkvi i ynë mons. Dodë Gjergji. Me këtë rast ipeshkvi ynë pati rastin filloi edhe vitin meshtarak, 150-vjetorin e lindjes së Shën Gjon Maria Vianney, pajtorit të famulltarëve dhe të gjithë meshtarëve të botës. Mons. Dodë Gjergji me hapjen e vitit meshtarak ai ua drejtoi edhe porosinë e vet nëpërmjet një letre baritore drejtuar meshtarëve, rregulltarëve, rregulltarëve, besimtarëve dhe të gjithë njerëzve vullnet mirë. Ai i ftoi të gjithë që sa më denjësisht të përmbyllin vitin e Shën Palit dhe me zemër të sinqertë të hyjnë në vitin e meshtarisë. Kjo ditë ishte vërtet një ditë e veçantë dhe një ditë feste dhe gëzimi për të gjithë. Numri i besimtarëve ishte i madh, aq i madh sa kisha në formë të barkës e ndërtuar në këtë



qytezë nuk i zinte. Por edhe pse ishte vapë dhe djersa nuk mungonte në fytërin dhe në trupin e të pranishmëve besimtarët përcollën me vëmendje mesheën shenjte dhe porosinë e ipeshkvit tonë.

Edhe në Jagodë gjithashtu u festua kjo festë me një solemnitë të madh. Edhe pse të pranishëm ishin një numër i vogël i meshtarëve, megjithatë i madh ishte numri i besimtarëve dhe atyre që janë të devotshëm Zemrës së Krishtit. Mesheën kryesore e udhëhoqi don Anton Uka, përgjegjës në Seminarin "Lazër Mjeda", në Prizren. Ai me fjalën e predikimit i ndihmoi të pranishmit që sa ma mirë ta përfetojnë këtë ditë madhështore. Mirë u pafshim në festat e famullive tona!

(Dritapress)

Në ambiente të reja

Kolping Kosova vijon projektin për aftësimin e të rriturve

Pas donacionit nga Gjermania, Shoqata Kolping Kosova ka rifilluar aktivitetin në ambiente të reja, të pajisura me kompjuterë dhe pajisje të tjera, për të vijuar me projektin e aftësimit të të rriturve, këtë herë në fushën e biznesit. Kryetari i Shoqatës Kolping Kosova, Nikollë Kërhanaj pohon se falë donacionit nga Gjermania Shoqata vijon aktivitetin në ambiente shumë më të mira, me një hapësirë më të madhe si dhe pajisur me kompjuterë të rinj. Ai thotë se Shoqata Kolping është shoqatë me një rrjetë ndërkombëtare të shpërndarë në mbi 50 vende të botës, ndërsa vetëm në Kosovë veprojnë rreth 15 degë të Shoqatës krye-



sistit nëpër famulli, ku të rinjtë zhvillojnë aktivitet. Themeluesi i kësaj shoqate, thotë ai, ka qenë një prift katolik që ka jetuar në shekullin XIX në Gjermani me emrin Adolph Kolping. Adolph Kolpingu në kohën kur ka jetuar ka ndihmuar shumë të rinj, të cilët në kohën e tranzicionit kishin mbetur në rrugë dhe pa perspektivë. Ai u siguronte strehë dhe i përkrahte në mënyra tjera këta njerëz, që ata të mbijetonin, thotë Kërhanaj. Shoqata Kolping në Kosovë ka filluar veprimtarinë e saj menjëherë pas luftës në vitin 1999. Në fillim Kolping Kosova ka realizuar disa projekte në rindërtim në rajonin e Pejës dhe ka ndihmuar në ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës në mbarë Kosovën. Më vonë Shoqata është orientuar në aftësimin profesional të të rriturve, thotë Kërhanaj. Përmes këtyre aktiviteteve Kolping Kosova mundohet që të përkrahë popullatën, të përkrahë femrën dhe rininë. Përmes këtyre kurseve dhe aktiviteteve mundohemi që t'u ndihmojmë këtyre grupeve të njerëzve që të integrohen në tregun e punës dhe të sigurojnë ekzistencën sqaron ai. Projekti më i rëndësishëm që Kolping Kosova ka realizuar deri më tani është ndihma qytetarëve, kryesisht punëkërkuess në Qendrën Rajonale të Punësimit në Prizren në aftësimin profesional në lëmin e biznesit bashkëkohorë.

Që nga vjeshta e vitit 2002 ka filluar së punuari Qendra për Aftësimin e të Rriturve „Kolping Kosova” në Prizren. Që atëherë në Prizren janë ofruar aftësime profesionale për: të rinjtë me shkollë të përfunduar, të papunët, ata që i rikthehen veprimtarisë profesionale, njerëzit

ai me Qendrën Rajonale të Punësimit në Prizren pa të cilën të arriturat tona do të ishin të mangëta, thotë ai dhe shton se nga aktivitetet e kësaj shoqate gjithësesi duhet të potencuar edhe punën e palodhshme të udhëheqësit shpirtëror Don Kelmend Spaçi nëpër familjet Kolping që është duke i realizuar me sukses, me vullnet dhe dashuri të pashoqe veprimtarinë në punën dhe organizimin e të rinjve dhe të rejave dhe këtë veprimtari do ta vazhdojë edhe në të ardhmen, ka premtuar ai.

Në kuadër të përpjekjeve për zgjerimin e aktiviteteve të veta, kryesia e shoqatës “Kolping Kosova”, me seli në Prizren, prej datës 17-24 qershor ka qendruar në qytetin Ender në Gjermaninë, në kuadër të aktivitetit kolping me seli të “Kolping Enderit” dhe “Kolping Kosova”, si dhe për mundësitë e zgjerimit të partneritetit edhe në qytetet e tjera në Gjermani.

Me këtë rast kryetari i shoqatës “Kolping Kosova” z. Nikollë Kërhanaj, udhëheqësit e Kolpingut të qytetit të Enderit i njoftoi për historikun e shoqatës “Kolping Kosova” që nga themelimi i saj e deri më sot. Ndërsa udhëheqesi shpirtëror i familjes kolping don Kelmend Spaçi i ka njoftuar për zgjerimin e familjeve të reja nëpër famulli të ipeshkvisë së Kosovës. Ndërkaj drejtori ekzekutiv i shoqatës “Kolping Kosova”, Z. Arben Thaqi në qytetin Enderit, para zyrtarëve të lartë të kësaj shoqate dhe shumë studentëve mbajti një ligjëratë për shtetin më të ri në botë, për republikën e Kosovës, me çrast prezantoi të arriturat e saj pas luftës e deri më sot, si dhe për zgjerimin e partneritetit të shoqatës “Kolping Kosova” me vendet e tjera si në Gjermani dhe në shtetet e tjera në botë. Pastaj foli për mundësitë që të rinjtë nga Kosova të studiojnë në Gjermani, duke mos e lënë anash pa e potencuar gjendjen e vështirë të shëndetësisë. Në këtë takim të përbashkët ishte edhe ipeshkvi i Osnabruck-it, i cili këto kërkesa po sa i dëgjoi nga drejtori ekzekutiv të z. Thaqi, i ka përkrahur në tërësi, duke potencuar se së shpejti do ta vizitojnë shoqatën “Kolping Kosova”, në seli në Prizren, gjë që Arben Thaqi u dëshiroj mirëseardhje në shtetin më të ri, në Republikën e Kosovës

Mark Paloka, gazetar

Më 29 qershor u festua dita e pajtorit të Kishës në Gjakovë dhe Poterq, Shën Pjetri dhe Shën Pali

Në meshën solemne të orës 11:00 për të parë n herë në kishën edhe pse ende të papërfunduar madhështore, e cila nuk mundte t'i pranonte të gjithë besimtarët e shumtë që shteguan për të nderuar keta dy apostujt nga koha e Krishtit. E udhëhoqi don Viktor SOPI famullitar në Ferizaj dhe Drejtor i Caritasit të Kosovës.

Në pretkun e rastit don Viktori theksoi rolin e shën Pjetrit në bashkësinë e parë kur Krishti ia besoi rolin udhëheqës në kishë. Nga shë n Pjetri i kemi edhe dy letra pastorale, ku ai trajton çështjet shpirtërore dhe disiplinare të kishës. Në vazhdim don Viktori foli për rolin e madhe në përhapje të lajmit të gëzueshëm që bëri shë n Pali duke theksuar edhe jubileun e madh, i cili kë të ditë përfundoi pikërisht në këtë kishë në Gjakovë kushtuar këtyre dy apostujve. Shën Pali ka shkruar pesëmbëdhjetë letra baritore me një stil vërtet lapidar, ka përfshirë mbarë thesarin e fesë, të teologjisë dhe të moralit. Me udhëtimet e tij misionare bëri që kisha të jetë e gjithëmbarshe duke i shtruar kështu themelet e qytetërimit dhe të kulturës së krishterë qytetare. Ai bëri së paku tri udhëtime apostolike në Mesdhe. Dhe me këto fjalë ai përfundon autobiografinë e vet “*Luftën e mirë e luftova, vrapimin e kështjës së ruajta. Qysh tash më pret gati kurora e drejtësisë, që atë ditë do të ma jep Zoti*” (2 tim 4, 7-8). Shën Pjetri dhe Shën Pali rreth vitit

67 janë martirizuar në Romë. për atë arsye aty është edhe qendra e krishtenizmit ku mbi varret e tyre janë ndërtuar bazilikat madhore.

Krejt në fund Don Viktori ftoi besimtarët që të bëhen me vullnetin e tyre një gurë ndërtues në këtë objekt të papërfunduar, i cili është vlera më e madhe që lidhe krejt shekujt si dëshmi të identitetit tonë kombëtar dhe fetar, duke potencuar se kjo është vlera më e madhe që ka ky shtet posa i krijuar, me të cilin duhet të krenohet.

Edhe në Poterq, filial ky i famullisë së Gllaviqicës, ku si pajtor kanë Shenjtërit Pjetrin e Palin, u kremtua kjo festë dhe mboldhi një numër të madh të besimtarëve, miqve dhe dashamirëve që kanë ardhur nga Lugu i Drinit, Lugu i Baranit dhe anëve tjera fqinje. Në këtë filial meshën kryesore, në ora 11 e udhëhoqi famullitari i Binqes don Albert Demaj. Së bashku me të koncelebruan edhe disa meshtarë të dekanatit të Pejës. Don Alberti në fjalën e rastit shkoqiti disa fragmente nga Shkrimi Shenjtë që kanë të bëjnë me jetën dhe shembullin e Shën Pjetrit e Palit dhe i ftoi gjithë ashtu edhe besimtarët që vazhdimisht të kërkojnë ndihmën dhe ndërmjetësinë e këtyre shenjtërve. Edhe kjo festë si në Gjakovë, Poterq dhe në vendet tjera u kremtua me solemnitë të madh. Nuk munguan edhe urimet atyre që mbajnë e emrat e bukur Pjetër e Pal.

(Dritapress)

Më 1 Korrik 2009 në Brezovicë, u mbajt mbledhja e meshtarëve në krye me ipeshkvin tonë Mons Dode Gjergjin

Në agjendën e këtij takimi ishte Caritasi i Kosovës.

Hapjen e takimit e bëri Don Viktor SOPI Drejtor i Caritasit të Kosovës, duke dëshiruar mirëseardhjen e të gjithëve në këtë takim. Don Viktori shkurtimisht prezantoi strategjinë e Caritasit të Kosovës, të cilën e kemi ndërtuar në bashkëpunim me Caritasat Ndërkombëtare, duke theksuar edhe angazhimin, përkushtimin personal në implementimin e saj. Në vazhdim Don Viktori theksoi ballafaqimin e tij në Caritas ku e gjeti në një gjendje kaotike, me probleme dhe sfida të ndryshme gjyqësore, problemet me institucionet pollicore, me largimin e shumë Caritasëve Ndërkombëtare, të cilat veç ishin larguar nga Kosova dhe nuk kishin bashkëpunime më tutje me Caritasin e Kosovës. Pastaj i ftoi të gjithë meshtarët që të shikojnë Caritasin e Kosovës si pjesë të vokacionit të tyre dhe si të tillë ta korrespondojnë.

Pastaj mori fjalën Mons. Dodë Gjergji, ipeshkvë, i cili bëri një vështrim të thukhtë si duhet të participohet në jetën e Caritasit, theksoi se Caritasi është mundësia jonë për të ndihmuar të tjerët.

Në këtë takim ku ishin të pranishëm po thuaj se të gjithë famullitarët e famullive tona, u cakta dita e Caritasit:

E katërta e diele e Krezhmeve. Kjo ditë do të shënohet edhe në Kalendarin e Kishës katolike si dite e Caritasit të Kosovës. Takimi vërtetë ishte Caritativ Vëllazëror. Në mbarim Don Viktori përmërsisht falënderoi të gjithë pjesëmarrësit duke i ftuar edhe njëherë që të kycen nëpërmes bordit të famullisë në projektet e Caritasit të Kosovës.

(Dritapress)

Enciklika e re e Papës “E vërteta në dashuri”

Do të paraqitet në konferencën e shtypit të 7 korrikut të ardhshëm, në orën 11.30, në Sallën e Shtypit të Vatikanit, Enciklika e re, e shumëpritur, e Benediktit XVI “Caritas in veritate” - “E vërteta në dashuri”. Parashikohen katër diskutime kryesore: ai i kardinalit Renato Raffaele Martino, kryetari i Këshillit Papnor për Drejtësi e Paqe; i kardinalit Paul Jozef Kordes, kryetari i Këshillit Papnor Cor Unum; i imzot Xhampaolo Kreppaliti, sekretari i Drejtësi e Paqe dhe i profesor Stefano Zamanjiti, pedagog i Ekonomisë Politike në Universitetin e Bolonjës dhe këshilltar i të njëjtit dikaster papnor. Gazetarët do të mund të njihen me tekstin në gjuhë të ndryshme: italiane, franceze, angleze, gjermane, spanjolle e portugeze. Dy ditë më parë, në lutjen e Enjëgjëllit të Tënzot të Shenjtorëve Pjetër e Pal, Papa njoftoi se pikërisht atë ditë kishte nënshkruar Enciklikën e tij të tretë, kushtuar temave shoqërore. Enciklika “E vërteta në dashuri”, është, pra, ftesë për ta thënë të vërtetën me dashuri. Papa shpjegoi edhe se në të trajton tematikat shoqërore, që përmban “Populorum progressio”, shkruar nga shërbëtori i Zotit, Pali VI, në vitin 1967: “Ka për qëllim të thellojë disa aspekte të zhvillimit të përgjithshëm në epokën tonë, porë në dritë




tën e së vërtetës, të thënë në dashuri. Ia besoj lutjes suaj – tha në përfundim Ati i Shenjtë – këtë kontribut të ri, që i jep Kisha njerëzimit,

në përpjekjen e saj për progresin e qëndrueshëm, plot respekt për dinjitetin njerëzor dhe për kërkesat e njëmendta të të gjithëve”.

U paraqit nga Shtëpia Botuese e Vatikanit libri që përmbledh katekezat e Benediktit XVI kushtuar Shën Palit

Katekizmat e Benediktit XVI përmbledhen nga Shtëpia Botuese e Vatikanit në një vëllim të vetëm, të pasuruar edhe me një koleksion ikonografik. “Shën Pali Apostull” është titulli i librit, që u paraqit dje në Romë, nga kardinali Giovanni Lajolo, kryetari i Governatoratit të Qytet-Shtetit të Vatikanit, së bashku me drejtorin e Shtëpisë Botuese dhe drejtorin e Muzeve të Vatikanit. Është vetëm një, nga botimet e shumta të SHBV për Apostullin e Popujve me rastin e Vitit që iu kushtua. Libri përmbledh 20 katekizmat e Benediktit XVI kushtuar Shën Palit – i pari mbajtur më 2 korrik 2008 – i fundmi, më 4 shkurt 2009, për t’i ndihmuar besimtarët ta njohin më mirë Apostullin e Popujve, dashurinë e tij të pakufishme për njeriun, shpirtin e



tij. Faqja e fundme e këtij cikli mbyllet me rrëfimin e martirizimit të Apostullit, fund i jashtëzakonshëm, që kthehet në fillim, sepse figura e Shën Palit – na

kujton Papa – i kapërcen kufijtë e jetës dhe të vdekjes e me kalimin e viteve bëhet aq madhështore, sa të frymëzojë viganë të tjerë të Kishës, nga Shën Agostini, tek Shën Toma. Katekizmat e plota të Papës kushtuar Shën Palit, të përkthyer në gjuhë shqipe, që mund t’i lexoni duke hapur faqen tonë të internetit në adresën : www.radiovaticana.org, së shpejti do të përmbledhen në një fletëpalosje, shoqëruar edhe me hollësira të tjera, që kanë të bëjnë me figurën e Shën Palit në botë e në Shqipëri, duke pasur parasysh se Apostulli i Popujve, është edhe ungjillëzuesi i fiseve të Ilirisë. E kjo dëshmon se Feja e krishterë tyre dhe e pasardhësve të tyre, shqiptarëve të sotëm, është me zanafillë apostolike.

Në Kazakistan u hap Kongresi III Ndërfetar

Një shkëmbim mendimesh për problemet e botës bashkëkohore, për të propozuar idetë e pajtimit ndërfetar në vendet e ndryshme, për të bërë vlerësime e për të dhënë këshilla: ky është edhe qëllimi i Kongresit III të liderëve fetarë botërorë e tradi-

ne. Delegacioni vatikanas kryesohet nga kardinali Zhan-Lyi Toran, kryetar i Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar. Kishën anglikane e përfaqëson ipeshkvi Nikolas Baines. Delegacioni i Kishës së Kostandinopojës kryesohet nga metropoliti i Francës. Në Kongres janë të prani-



cionalë, që u hap sot në Astana të Kazakistanit. Në këtë takim dyditor, që do të përfundojë nesër, marrin pjesë delegacione të feve të ndryshme të botës, të ftuar nderi dhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare (të OKB-së, OSBE-së e Uneskos). “Roli i liderëve fetarë për ndërtimin e një bote tolerante në epokën e globalizimit” është tema e ditës së parë, plenare, të takimit të madh. Ndërsa nesër, të pranishmit, të ndarë në tre grupe, do të shkëmbejnë mendime rreth tri temave: pasuria morale e kulturore dhe etika botërore; dialogu e bashkëpunimi, solidariteti, posaçërisht në kohë krizash. Nga bota e krishterë janë të pranishëm Kisha katolike, anglikane, ruso-ortodokse, ortodokse e Kostandinopojës dhe e Rumanisë, të dyja Kishat apostolike armene dhe Federata Botërore Luterane.

shëm edhe Ishmael Noko, sekretar i përgjithshëm i Federatës Botërore Luterane dhe sekretar i përgjithshëm i Bashkimit Luteran Botëror. Për Islamin do të flasin delegacioni i Egjiptit, i Indisë, i Indonezisë, Iranit, Turqisë, Libisë, Emirateve Arabe të Bashkuara, Kuvaitit, Kinës, Rusisë, Kirgizistanit, SHBA-së, Arabisë Saudite e Pakistanit. Të pranishëm, edhe përfaqësues të tjerë të lartë të Hebrazmit, të Budizmit, të Shintoizmit, Induizmit, Taoizmit, Zoroastrizmit. Në përfundim të takimit do të hartohet një dokument i përbashkët. Punimet e paraqitjes së edicionit 2009 nën kujdesin e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së filluan pas fjalimit të presidentit kazakistanas, Nazar-bajev në Asamblesë e Kombeve të Bashkuara, vitin e kaluar.

Papa: vlerat etike e morale janë të rëndësishme në politikë.

Duke përshëndetur në mbarrim të audiencës së përgjithshme grupet e ndryshme të pranishme në audiencë, e në mënyrë të posaçme përfaqësuesit e Shoqatës italiane ndërparlamentare “Lëvruet të etikës”, Papa ka nënvizuar rëndësinë e vlerave etike e morale në politikë. Pastaj, duke përshëndetur përfaqësuesit e Këshillit italian kundër fajdesë, ngriti zërin në favor të viktimave të kësaj shuplake shoqërore:

“I xix të gjithë të impenjohen me një hov të ri për t’iu kundërvënë me sukses fenomenit, shumë të përhapur, të fajdesë e të marrjes me dhunë të borxhit, gjë që është tjetër, veçse një skllavëri poshtëruese. Uroj që, edhe nga ana shtetit, familjeve nevojtare, të cilat marrin guxim t’i denoncojnë ata, që përfitojnë nga kushtet e tyre, shpesh herë tragjike, të mos u mungojë ndihma e mbështetja e nevojshme”.

Benedikti XVI pastaj, një për-



shëndetje për njerëzit që, në këtë periudhë pushimesh, për arsye nga më të ndryshmet, nuk mund të kalojnë disa çaste çlodhjeje, duke u uruar të mos u mungojë solidariteti e afërsia e njerëzve të dashur. Edhe një urim i fundmë. Papa ua drejtoi të rinjve, që në këto ditë po japin provime, duke i siguruar se i kujton në lutje.

(Marrë nga Radio Vatikani)

Jakobi, i vjetri

PËRGATITI:
Don Marjan MARKU

Në edhe kësaj radhe dëshirojmë të vazhdojmë me shpërgimin e portreteve të apostujve, të cilët Jezusi i zgjodhi deri sa jetonte në tokë. Deri më tani kemi shkruar për Shën Pjetrin dhe vëllai e tij Andreun. Në renditjen e 12 apostujve, ne takojmë dy apostuj me emrin Jakob: Jakobin të birin e Zebedeut edhe Jakobin tjetër të birin e Alfeut (Krah. Mk 3,17-18; Mt 10,2-3), të cilët pasi që kanë një emër të njëjtë për t'i dalluar janë emëruar si "Jakobi i vjetër dhe Jakobi i ri. Këto emëtime nuk e tregojnë madhësinë e tyre apo shenjtërinë e tyre, por vetëm kuptimin e dallimit, të cilët në shkrimet e Besëlidhjes së Re kanë një domethënie të rëndësishme në jetën tokësore të Jezusit. Sot do i kushtojmë vëmendje njërit prej këtyre dy personave me një emër. Emri Jakob është përkthim nga "Iakobos", formë e greqizuar e emrit të Jakobit të njohur nga Besëlidhja e Vjetër apo para-atit Jakob. Apostulli me këtë emër është vëllai i Gjonit dhe është i renditur në vendin e dytë, menjëherë pas Pjetrit tek ungjilli sipas Markut (Mk 3,17), ndërsa tek ungjilli sipas Mateut dhe Lukës gjendet

në vendin e tretë të renditjes, pas Pjetrit dhe Mateut (Mt 10, 2; Lk 6, 14) ndërsa në Veprat e Apostujve pas Pjetrit dhe Gjonit (Vap 1, 13). Ky Jakob së bashku me Pjetrin dhe Gjonin, janë tre nxënës të cilët marrin pjesë më së shumti në jetën e Jezusit apo janë të pranishmit dhe të rëndësishmit për të.

Jakobi së bashku me Pjetrin ishte i pranishëm në agoninë e Jezusit në kopshtin e Gjetsemanit, po ashtu edhe në momentin e shndërrimit. Janë dy situata të cilat janë krejtësisht të ndryshme njëra prej tjetrës. Në një rast Jakob së bashku me dy apostujt tjerë e përjetuan lavdinë e Zotit, ai e pa Moisiun edhe Elinë duke biseduar me Jezusin, ai e pa Jezusin të shndërruar në mënyrë hyjnore; ndërsa në rastin tjetër qëndroi pranë Krishtit me plot vuajtje dhe përvujtëri, ai e pa me sy të vet se si përvujtërohet biri i Hyjit dhe se si ëshëmtë i dëgjueshëm deri në vdekje. Përfjetimi i dytë për të ishte një mundësi për tu rritur në fe edhe për ta korrigjuar një anshmërinë e triumfalizmit të cilin e përjetoi në momentin e shndërrimit të Krishtit. Ai u desh që ta shohë se ardhja e Mesisë, të cilin e priste populli hebrej si një triumf nuk do të jetë vetëm një triumf, por në realitet do të jetë një vuajtje dhe ligshiti. Lavdia e Krishtit

“ Jakob i së bashku me Pjetrin ishte i pranishëm në agoninë e Jezusit në kopshtin e Gjetsemanit, po ashtu edhe në momentin e shndërrimit. ”

u realizua pikërisht në kryq, në pjesëmarrje të jetës sonë.

Kjo rritje në fe, e cila filloi duke jetuar me Jezusin përfundoi me marrjen e Shpirtit Shenjt në ditën e Rrëshajëve, dhe kështu për Jakobin arriti momenti i dëshmisë më të madhe që askush nuk mund t'ia marrë. Në fillim të viteve dyzet të shekullit të parë, Herodi (Agripa) mbret, një nip i Herodit të madh, sipas tregimit



“ Nëse ne sikurse edhe Shën Jakobi shkojmë pas Krishtit, do të jemi të vetëdijshëm se gjatë jetës tokësore do të takojmë edhe situata të vështira. ”



të Lukës dhe urdhër: »që ti salvojë disa anëtarë të Kishës. Me shpatë e preu Jakobin, të vëllanë e Gjonit« (Vap 12, 1-2). Ky detaj i vogël dhe i qartë në një anë na tregon se sa ka qenë normale për të krishterët për të dëshmuar dhe për ta dhënë jetën e tyre për Krishtin, dhe në anën tjetër çfarë qëndrimi të rëndësishme ka pasur Jakobin në kishën e Jerusalemit po ashtu edhe në jetën e Jezusit deri sa ishte në tokë. Një gojëdhënë më e vonshme na tregon se Jakobin ka predikuar Ungjillin e Krishtit edhe në Spanjë edhe në pjesët e rëndësishme të mbretërisë Romake. Ndërsa një gojëdhënë tjetër na tregon se trupi i tij është batur në Santiago de Compostela (Spanjë). Siç e dimë kym qytet është bërë një ndër qendrat më të rëndësishme të botës së krishterë për shtegtim ku vijnë njerëzit nga e gjithë Evropa e bota. Paraqitja ikonografike e tregon Shën Jakobin me shkop të shtegtarit dhe me një ungjill në dorë, një shenjë e një apostulli në ecje apo lëvizje i cili predikon lajmin e gëzueshëm dhe dëshmon shtegtimin e jetës së krishterë.

Nga Shën Jakobi mund të mësojmë shumë: duke qenë të gatshëm për ta pranuar thirrjen

e Zotit duke e lënë »anijen« e sigurisë sonë njerëzore dhe duke shkuar me gëzim pas jetës së tij, të cilën na e tregon, e cila i tejkalon të gjitha iluzionet tona; që të jemi të gatshëm edhe guximtarë nëse është nevoja deri edhe në flajimin më të madh, duke e flijuar edhe jetën tonë. Kështu qëndron para nesh Jakobi i vjetër, i cili me zemër është shembull i besimit të madh për Krishtin. Ai, i cili përmes nënës së vet, e cila iu lut Jezusit për dy bijtë e saj që njëri të jetë në të djathtën e tjetri në të majtën e tij, ishte i pari i cili e piu këlkun e vuajtjes duke e dëshmuar martirizimin së bashku me apostujt tjerë.

Dhe, për fund, mund të bëjmë një përmbljedhje të shkurtyr duke thënë, që jo vetëm rruga e jashme, por para së gjithash rruga e brendshme prej bregut të shndërrimit deri në breg të Agonisë, e simbolizon tërë jetën e shtegtitimit të Jezusit, një shtegtim në mes përndjekjeve botërore dhe ngushëllimeve hyjnore, siç thotë edhe Koncili i Dytë i Vatikanit. Nëse ne sikurse edhe Shën Jakobi shkojmë pas Krishtit, do të jemi të vetëdijshëm se gjatë jetës tokësore do të takojmë edhe situata të vështira.

Pse një “vit priftëror”?

“Një vit në të cilin rizbulojmë bukurinë dhe rëndësinë e meshtarisë” (Kard. Hummes)

Meditim nga:
Mons. George Frendo O.P.

Qëllimi i këtij viti është shprehur në takimin e Benediktit XVI me Kongregatën për Klerin (më 16 mars), me këto fjalë: “të favorizojmë këtë shtrirje pozitive të priftërinjve drejt përsosmërisë shpirtërore nga e cila mbi të gjithë varet efekshmëria e shërbesës së tyre”. Por besoj ka qenë edhe një arsye tjetër që e ka shtirë Papën të vendosë këtë vit: fakti që shumë skandale të priftërinjve janë zbuluar në këto vite të fundit, veçanërisht nga viti 1992 (mjafat të përmetim çështjen e ipeshkvit Casey në Irlandë në vitin 1992 dhe atë të kardinalit Groër në Austri në vitin 1995, dhe shumë skandale pedofilie në Irlandë, Angli, Shtetet e Bashkuara....). Këto skandale kanë krijuar jo vetëm një krizë për besueshmërinë e Kishës (sidomos të priftërinjve), por edhe një krizë identiteti tek vetë priftërinjtë.

Për këtë arsye Kard. Hummes, në letërën e 3 prillit tha se do të jetë “një vit në të cilin rizbulojmë bukurinë dhe rëndësinë e priftërisë”, “rast për një kuptim më të thellë teologjik dhe shpirtëror” të priftërisë. Në një letër të shkruar më vonë, Hummes foli më qartë: “Është e vërtetë se disa priftërinj janë përfshirë nganjëherë në probleme të rënda dhe situata krimesh. Qartë se duhet të vazhdojnë hetimet mbi ta, të gjykohen siç e meritojnë dhe të ndëshkohen”.

Hapja dhe mbyllja e këtij viti koïncidon me festën e Zëmrs

së Krishtit, që para disa vitesh u caktua edhe si “Dita e shenjtëritëmit priftërore”. Por ky vit kremtohet edhe me rastin e përvjetorit të 150ë të vdekjes së shën Gjon Maria Vianney, që jo vetëm ishte bari model, por edhe një paradoks i hirit të Zotit. Një ditë një prift e ka ngacmuar: “Pse Zoti ka zgjedhur një gomar si ti?” Gjon Maria iu përgjigj: “Samsoni, me një nofull gomari, vrau një mijë filistenj. Sa më shumë mund të bëjë Zoti me një gomar të terë!” Gjon Maria Vianney na mëson mos të besojmë në vetveten dhe në aftësitë tona, por në hirin e Zotit!

BESNIKËRIA E KRISHTIT DHE BESNIKËRIA E PRIFTIT

Pra titulli i vendosur nga Benedikti XVI për këtë vit është: “Besnikëria e Krishtit dhe besnikëria e Priftit”.

Si e përshkruajmë besnikërinë e Krishtit? Së pari është gatishmëria e tij për të zbatuar besnikërisht misionin e tij, pa asnjë kompromis. Shën Pali e ka shprehur me këto fjalë: “Në Krishtin nuk kishte ‘po’ dhe ‘jo’, por vetëm ‘po’”. Jezusi, pra, nuk ka bërë asnjë kompromis: jeta e tij ishte vetëm “po” planit të Atit dhe misionit të vet.

Së dyti, është autenticiteti e tij. Në Ungjillin e Gjonit lexojmë se një ditë “farisenjtë dëgjuan se këto po pëshpërteshin në popull për të e prandaj kryepriftërinjtë e farisenjtë dërguan rojtarët për ta kapur.... U kthyen, pra, rojtarët të kryepriftërinjtë e të farisenjtë dhe këta u thanë: ‘Pse nuk e sollët?’ Rojtarët përgjigjën: ‘Asku-

rrë askush s’ka folur si ky njeri!’” Ndërsa në Ungjijtë Sinoptikë lexojmë se “Fliste me autoritet, dhe jo si skribët e farisenjtë”. E pse? Sepse veprat e tij ishin krejt në përputhje me mësimin e tij. Asnjëri nuk mund të vërtetonte se ai kishte mëkatuar.

Dhe përballë besnikërisë së Krishtit jemi të nxitur të pyesim vetveten për besnikërinë tonë. Të gjithë kemi studiuar teologji, dhe kjo mund të na bëjë ekspertë për të justifikuar vetveten. Ndoshta jemi mësuar të bëjmë kompromis me celibatin tonë, të bëjmë kompromis me dimensionin kontemplativ të jetës sonë. Ndoshta as gjejmë asnjë problem të harxhojmë shumë orë para TV ose me internetin, duke braktisur detyrën tonë të lutemi.... Sa shumë priftërinj kanë harruar kur janë lutur me Liturgjinë e Orëve për herë të fundit, sa shumë tjerë kanë harruar në cilin vit kanë bërë për herë të fundit ushtrime shpirtërore vjetore! Sa shumë mund të bëjnë një predikim shumë të bukur për alegorinë e hardhisë, por pa bërë me të vërtetë eksperiencën e shërmendit të bashkuar me hardhinë!

Tre folje të para që kemi mësuar në çdo gjuhë ishin sigurisht: jam, kam, bëj. Në këtë rend. Sot, mentaliteti pragmatist (pas filozofisë së Karl Marx-it dhe Wissliam James-it), rendi ka ndryshuar ashtu: bëj, kam, jam.

Thoshin Skolastikët: Agere sequitur esse. Por sot ekzistencialistët thonë: Esse sequitur agere. Kjo mund të ketë pasojë edhe në jetën tonë. Ja pse në je-

tën e shumë priftërinjve gjendet një boshllëk i madh.... duan të japin, por s’kanë ç’të japin!

Duhet të kuptojmë se Zoti nuk na ka thirrur së pari për t’i shërbyer, POR që Ai të kapë ne, dhe të jetë kapur nga ne, si është shprehur shumë mirë Pali: “vrapoj që, në ndonjë mënyrë, të mund ta zë (Krishtin), sepse edhe vetë kam qenë zënë prej Krishtit” (Fil 3). Si tha Kard. Hummes: “Priftërinjtë janë të rëndësishëm jo vetëm për atë që bëjnë, por edhe për atë që janë”. Madje duhet të themi (si kishte thënë Papa Gjon Pali II në një fjalim për priftërinjtë dhe rregulltarët): “Priftërinjtë janë më të rëndësishëm për atë që janë sesa për atë që bëjnë.”

Prifti që nuk jeton në përputhje me thirrjen e tij, domethënë nuk është besnik ndaj thirrjes së tij, jeton në kundërshtim me vetveten, dhe kështu as mund të kuptojë vetveten as të tjerët nuk mund të kuptojnë atë: kush është dhe çfarë është? Gjon Pali II shpeshherë fliste për divorc mes fesë dhe jetës. A mos ndoshta jemi edhe ne viktimë të një divorci të tillë?

Jezusi, duke na ka thirrur, na “shikoi ëmbël” (Mk 10, 21). Përgjigja jonë është “po” dashurisë së Zotit që na ka thirrur. “Besnikëria e Krishtit, besnikëria e priftit” tregon, sipas Kard. Hummes, “përparësinë absolut të hirit dhe, njëkohësisht, lidhjen e domosdoshme të zemrës të asaj lirie që dashuron, duke kujtuar se, emri i dashurisë, në kohë, është ‘besnikëri’” (“il primato assoluto della grazia, e, nel contempo,

l’indispensabile cordiale adesione della libertà amante, memoria che, il nome dell’amore, nel tempo, è ‘fedeltà’”.

IDENTITETI I PRIFTËRISË SË KRISHTERË

Ministeri priftëror në Besëlidhjen e Re është një fenomen specifikisht i krishterë. Fjala hierëus përdoret nga Jezusi vetëm në shëmbëlltyrën e Samaritanit të mirë dhe kur u tha të gërbururve: “shkoni tek priftërinjtë”. Në terë Besëlidhjen e Re përdoret ose në lidhje me Krishtin (Heb) ose në lidhje me terë popullin e krishterë (i Pjt).

Fjalët dhe koncepte që përdoren për priftërinë tek paganët dhe në Besëlidhjen e Vjetër nuk ishin të përshtatshme për të treguar ministerin e krishterë. Priftëria e Besëlidhjes së Re nuk është vazhdimi i priftërisë së Besëlidhjes së Vjetër: është diçka krejt e re. Prandaj Besëlidhja e Re përdor një terminologji të re: episkopos (rojë), presbiteros (plak, këshilltar), hegoumenos, proistamenos, proestotes (udhëheqës), poimenes (bari), oikonomos (udhëheqës i shtëpisë).

Kardinali Hummes tha se “ky vit do të jetë edhe një rast për një periudhë thellimi intensiv të identitetit priftëror”.

Por gjatë shekujve janë parqitur “fizionomi” apo perspektiva të ndryshme të priftërisë së krishterë. Besoj se mund t’i sintetizojmë në katër perspektiva.

A. Perspektiva Kultuale: Prifti është njeriu që ofron flinë eukaristike dhe administron sakramenta (ja origjina e fja-



lës "meshtar" për prift – që nuk është e saktë). Kjo ide ishte propozuar nga shumë teologë pas Koncilit të Trentos. Por ky interpretim injoron munus propheticum (mësues) dhe munus regale (bari). Dhe Vatikani i II thotë shprehimisht se detyra e parë e priftit ministerial është shërbimi i Fjalës.

B. Perspektiva Ashtike: Prifti është njeriu i shuguruar për ta vazhduar misionin e Fjalës së Mishëruar: adhurim e shëlbim. Kjo perspektivë ishte propozuar nga École Française e shekullit 17 (veçanërisht nga Charles de Condren) – prifti si "njeriu i Zotit". Por kjo perspektivë është më shumë një pikëpamje ashetik sesa teologjik, shumë e përshtatshme për të përshkruar përshtatshëm ministeriale.

C. Perspektiva e Shenjës: Prifti është njeriu-shenjë i Krishtit Krye për shërbimin e Kishës. Kjo perspektivë u propozua nga Karl Rahner. Atëherë prifti është përfaqësues i Krishtit Krye, për shërbimin e Popullit të Hyjit. Por, pyes unë, esenca e priftërisë gjendet pikërisht në faktin që është një "shenjë" e tillë, apo më mirë duhet të themi se ka diçka tjetër më themelore, në sajë të së cilës bëhet një "shenjë" e tillë?

D. Perspektiva e Ndërmjetësimit: Prifti është njeriu-ndërmjetësues mes Hyjit dhe njerëzve, me një ndërmjetësi të dyfishtë: ngritëse (ascendens, sepse i çon drejt Zotit lutjet dhe aspiratat e popullit) dhe zbritëse (descendens, sepse i komunikon popullit hretet e Zotit). Kjo perspektivë ka mbështetjen e Biblës dhe të Traditës teologjike kato- like, veçanërisht e shën Tomës. Kjo ndërmjetësi përfshin trip- lex munus: profetik, priftëror, mbretëror, nëpërmjet shpalljes së Fjalës, administrimit të sakra- menteve, dhe udhëheqjes në da- shuri. Pjesëmarrës në ministerin e Krishtit. As mund të themi se kjo perspektivë cenon ndërmje- tësimin e Krishtit. Sepse, si tha Koncili Vatikani II (në Kap. 8, n. 62 i Kushtetutës Lumen Gen- tium), "sikurse në priftërinë e Krishtit në mënyra të ndryshme marrin pjesë edhe ministrat dhe besimtarët, ... po ashtu edhe ndërmjetësia një e vetme nuk e përjashton, por zgjon në krijesat bashkëpunime të ndryshme që rrjedhin nga një burim".

RRJEDHOJA PËR JETËN SHPIRITËRORE TË PRIFTIT

a. Ndërmjetësia "ngritëse" vë më shumë në dukje dimensionin kontemplativ të jetës së priftit. Yves Congar, në një shkrim mbi jetën priftërore, tha se lutja me- ndore duhet të jetë për priftin si oksigjeni apo fryma e tij. Kardi- nali Basil Hume, në librin e tij Searching for God, ka shkruar se prifti nuk mund të ndihet i sigurt në botën e apostollimit përveç kur ndihet i "rëhatshëm" në "shkretëtirë (dimensioni kon- templativ i jetës së tij). Michael Ramsey, ish-arqipeshkvi angli- kan i Canterbury, në librin e tij

të bukur Priests Today (që mban fjalimet e tij dhënë candidaëve për priftërinë një ditë para shu- gurimit të tyre priftëror) tha se prifti është: a. mësuesi dhe pre- dikatori i Fjalës, b. ministri i paj- timit, c. njeriu lutjeje, d. njeriu i eukaristisë. Të gjithë të krishte- rët janë njerëz lutjeje, por të jetë njeriu lutjeje është punë specifi- ke e priftit.

Dhe në fakt ashtu na mbajnë njerëzit. Dhe, pikërisht për këtë arsye, tregojnë besimin e tyre ndaj nesh kur na thonë: "Lutu për mua".

b. Ndërmjetësi "zbritëse" thekson rolin ministerial të priftit. Në Heb lexojmë: "Çdo krye- prift zgjidhet nga mesi i njerëzve, dhe vihet kryepriфт për të mirën e njerëzve në marrëdhënie të tyre me Hyjin". Vërtet, bëhet fjalë për priftërinjtë e Besëlidhjes së Vje- tër, por janë domethënëse edhe për ne. Jemi shërbëtorët e popu- llit, të cilit i shërbejmë me gë- zim. Dhe shumë dokumente pas Koncilit këmbëngulin dashurinë që prifti duhet të tregojë ndaj të varfërve.

c. Të dy dimensionet na kuj- tojnë dy virtyte për të cilat sot flitet shumë pak: shpirtmadhësi dhe përvujtëri. Me fjalë të tjera, jeta jonë duhet të jetë një luftë e vazhdueshme kundër mediok- ritetit dhe krenarisë, duke pas- sur parasysh fjalët e shën Palit: "Gjithçka mundem (=shpirtma- dhësi) me ndihmën e atij që më jep fuqi (= përvujtëri)" (Fil 4, 13 – shih edhe Fil 3, 8-9, 12-14). Kjo do të thotë: të jesh njëkohësisht i rritur dhe i mitur. Është e vështirë të rritesh, sepse kjo kërkon të luftosh çdo ditë për t'u rritur. Por është më e vështirë të bëhesh i mitur, sepse kjo kërkon të më- sosh të varesh nga dikush tjetër e të pranosh nga ai, për të thënë: "Jetoj, por jo më unë, në mua je- ton Krishti" (Gal 2, 20).

Mëkati është dorëheqja e "të miturit" në ne: është përpjekja për t'u bërë vetë-mjaftueshëm. Ky ishte mëkati i Adamit dhe Evës: deshën të bëheshin të pa- varur, dhe të bëheshin vetë kri- ret e së mirës dhe të së keqes.

Rruga për lumturi është rruga e përvujtërisë, dhe kjo kërkon vetë-mohimin. Dhe përvujtëria nuk është kompleksi i inferiori- tetit, që mund të jetë maskë për një krenari të fshehur.

d. Përgjegjësia jonë përpara popullit është e madhe! Njerë- zit kanë të drejtë të shohin tek ne model feje, lutjeje, dashurie, përvujtërie. Ndoshta kemi tepë- ruar dhe abuzuar me doktrinën e Trentos rreth efektshmërisë e sakramenteve "ex opere operato" dhe kemi harruar rolin e minis- trit të sakramenteve, "opus ope- rantis". Edward Schillebeeckx, në librin e tij të falshëm Christ the Sacrament of Encounter with God ka folur për këtë rol, dhe tha: mos të habitemi se disa njerëz parapëlqejnë të shkojnë për rrefim tek një prift më shumë sesa tek një tjetër, ose të shkojnë për një meshë të kremtuar nga një prift më shumë sesa nga një

“ Kërkoni që të nxisni një priftëri të vërtetë vëlla- zërore që të kontribuojë të fitojë izolimin dhe vet- minë, duke favorizuar kështu mbështetjen e njëri-tjetrit. Është e rëndësishme që të gjithë priftërinjtë të ndjejnë praninë atërore dhe miqësinë e Ipeshkvit. Papa Benedikti XVI ”



prift tjetër.

e. Thashë se Zoti nuk na ka thirrur së pari për t'i shërbyer, POR që të kapë ne, dhe të jetë kapur nga ne. Prifti është "i shu- guruar", sipas modelit të Krish- tit – në dimensionin vertikal dhe horizontal. Pra shugurim dhe mision janë të ndërsjellë. Mision unë është gjithmonë në emrin e Krishtit. Pra jeta jonë duhet të pasqyrojë jetën e Krishtit, i cili erdhi: (a) për ta kryer vullnetin e Atit (Gjn 4, 34; 5, 30; 6, 38), (b) për të shërbyer, jo për të qenë i shërbyer (Mt 20, 28; Mk 10, 45), (c) për të dhënë jetën e vet për delet (Gjn 10, 1-16).

Dhe dëshiroj të mbaroj me dy tekste të shkurtra nga Pastores

Gregis, nn. 15 dhe 47:

"Para, se të jetë një transme- tues i Fjalës, Ipeshkvi, së bashku me priftërinjtë e tij dhe si çdo besimtar, si vetë Kisha, duhet të jetë dëgjues i Fjalës".

"Ipeshkvi gjithmonë do të kërkojë të veprojë me priftërinjtë e tij si atë dhe vëlla që i do, i dë- gjon, i pranon, i korrigjon, i ngu- shëllon, që kërkon bashkëpunim dhe, për sa të jetë e mundur, an- gazhohet për mirëqenien e tyre njerëzore, shpirtërore, minist- riale dhe ekonomike".

Dhe në fjalimin e Papës Be- nedikt XVI drejtuar ipeshkvij- ve (më 22 shtator 2009) ai tha:

"Në veçanti, kujdesuni për priftërinjtë, bashkëpunëtorët dhe

parë dhe të pazvëndësueshëm në minister, dhe për të rinjtë. Qëndrojnë pranë me vëmendje priftërinjve. Mos i kurseni forcat të vendosni në veprim të gjitha iniciativat, duke përfshirë edhe atë të një bashkimi jete konkrete të dhënë nga Koncili Vatikani II, falë së cilës priftërinjtë të ndih- mohen të rriten në dedikimin ndaj Krishtit dhe në besnikëri ndaj ministerit priftëror.

Kërkoni që të nxisni një prif- tëri të vërtetë vëllazërore që të kontribuojë të fitojë izolimin dhe vetminë, duke favorizuar kështu mbështetjen e njëri-tjetrit. Është e rëndësishme që të gjithë priftë- rinjtë të ndjejnë praninë atërore dhe miqësinë e Ipeshkvit."

Shën Pali: apostulli i popujve

■ SHKRUAN:
Don Albert DEMAJ

Nga 28 qershori 2008 deri më 28 qershor 2009 Kisha Katolike kremtoi 2000-vjetorin e ditëlindjes të njërës nga misionarët më të mëdhenj të krishterimit – shën Palit apostull nga Tarsi. Vitin e shën Palit e pati hapur Papa Benedikti XVI në bazilikën e shën Palit jashtë mureve të saj. Aty i hapi dyert të quajtur Porta Paoline dhe ndezi zjarrin e shën Palit që mbeti i ndezur tërë vitin.

Apostulli Pal, figurë e jashtëzakonshme, pothuajse e paimitueshme e, megjithatë, nxitëse, është për ne shembull i përkushtimit të plotë ndaj Zotit e Kishës së tij, përveçse njëri që bashkëpunoi ngushtë me njerëzimin e me kulturën e ndryshme. Është e drejtë, prandaj, t'i kushtohet vëmendje e posaçme, e jo vetëm duke e nderuar kujtimin e tij, por edhe duke u përpjekur të kuptojmë atë që dëshiron të na thotë edhe ne, të krishterëve të sotëm, thoshte Papa Benedikti XVI në hapjen e këtij jubileu. Motoja e këtij viti ishte: "Jetoj, por jo më unë, në mua jeton Krishti." (Gal 2, 20).

Viti i shën Palit në Dioqezën tonë

Edhe ne në ipeshkvin tonë formuam Këshillin organizativ i



Mons. Dodë Gjergji gjatë fjalimit të tij në Simpozium

cili gjatë tërë këtij viti organizoi takime të ndryshme shpirtërore: me klerin, rregulltarët, me bashkësitë tona famullitare.

Simpoziumi në Prishtinë

Nëse populli ynë dëshiron të tregojë autoktoninë e vet dymijë vjeçare në këto troje, ai këtë mund ta bëjë vetëm nëpërmjet krishterimit, thoshte R. Mejdani, ish presidenti i Shqipërisë. Shën Pali më shumë se çdo kush tjetër dëshmon lashtësinë, autoktoninë, traditën dhe kulturën tonë të lashtë

iliro - shqiptare si dhe krishterimin tonë dymijë vjeçar. Lirisht mund të themi se fal shën Palit ne si popull kemi hyrë në librin më të lexuar në botë – Bibël. Nëpërmjet shën Palit ne vërtet jemi popull biblik, që është privilegj dhe mburrje për ne, gjë të cilën nuk e kanë shumë popuj tjerë të Evropës apo të botës.

Me dëshirë që këtë figurë madhore të Kishës sonë me interes të veçantë edhe për historinë tonë kombëtare, t'ia afrojmë edhe publikut tonë shqiptarë, ne me 10 qershor 2009 në Bibliotekën kombëtare në Prishtinë, në bashkëpunim me Universitetin Mbretërorë Iliria dhe në mbështetjen e Parlamentit të Kosovës, organizuam Simpoziumin shkencorë ndërkombëtar me titull: *Shën Pali – Apostulli i popujve dhe ungjillëzuesi ynë.*

Me ligjëratat e tyre u paraqitën shumë studiues nga Kosova, Shqipëria e më gjërë. Ipeshkvi ynë Mons. Dodë Gjergji, në fjalën e rastit ndër të tjera theksoi: shën Pali, apostulli i popujve dhe ungjillëzuesi ynë, ishte ai i cili na e solli farën e parë

kën kombëtare në Prishtinë, në bashkëpunim me Universitetin Mbretërorë Iliria dhe në mbështetjen e Parlamentit të Kosovës, organizuam Simpoziumin shkencorë ndërkombëtar me titull: *Shën Pali – Apostulli i popujve dhe ungjillëzuesi ynë.*

Me ligjëratat e tyre u paraqitën shumë studiues nga Kosova, Shqipëria e më gjërë.

Ipeshkvi ynë Mons. Dodë Gjergji, në fjalën e rastit ndër të tjera theksoi: shën Pali, apostulli i popujve dhe ungjillëzuesi ynë, ishte ai i cili na e solli farën e parë

të krishterimit, nëpërmjet të predikimit të lajmit të mirë, ungjillit të Zotit tonë Jezu Krishtit si dhe me institucionalizimin e kishës në trojet tona.

Kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës dr. Jakup Krasniqi, tha: *E përkujtojmë me nderim misionin e shën Palit për përhapjen e mirësisë, dashurisë, paqes, tolerancës dhe urtësisë. Veçanërisht e përkujtojmë, sepse në rrugëtimin e tij nëpër vise të ndryshme të antikitetit, zgjodhi edhe Ilirinë, zgjodhi paraardhësit tanë, duke na bërë kështu pjesë të filozofisë së re për një drejtësi e solidaritet njerëzore. Sipas tij merita kryesore e shën Palit është se ai e konsideroi besimin, jo si privilegj të njerëzve të ditur, të njerëzve me pozitë të lartë në shoqëri ose si monopol të një populli dhe kobe të veçantë, por si pasuri shpirtërore dhe mundësi për ta përmirësuar dhe për ta zhvilluar botën nëpërmjet besimit dhe dashurisë, ndihmës dhe solidaritetit për njëri tjetrin. Ai në vazhdim potencoi se me të drejtë mund ta quajmë apostullin shën Pali shpallës, dëshmitar dhe ungjillëzues të paraardhësve tanë. Ky jubile, vazhdoi ai, që përkon me vitin e dytë të Pavarësisë së Kosovës, duhet t'i nxisë mendjet e mblodhura këtu për të na ofruar një pasqyrë komplekse nga pikëpamja historike, arkeologjike, etnologjike dhe biblike me të dhëna të historisë sonë për shën Palin. Kjo duhet të na vetëdijësojë edhe për realitetin e sotëm, realitet i cili ka nevojë për figura si*



Kryeparlamentari Jakup Krasniqi dhe Mons. Dodë Gjergji gjatë Simpoziumit



Prof. dr. Jahja Drançolli



shën Pali që është sakrifikuar për të mirën e njerëzimit. Misioni i tij do të ishte i pamundur po qe se në udhëtimin e tij nëpër Iliri nuk do të ishte pritur me dëshirën e degjimit dhe të përqafimit, të shpresës dhe të mesazhit që shën Pali i shërbente me një përkushtim martirizues, për të cilin thekson: Kështu, qysh prej Jerusalemit e përgark në Iliri e kam përhapur Ungjillin e Krishtit, përfundoi Krasniqi.

Në vazhdim fjala iu dha Mons Lucijan Avgustini sekretar i përgjithshëm i Konferencës ipeshkvore të Shqipërisë, i cili përpos tjerash tha: *Kjo figurë e jashtëzakonshme, për ne shqiptarët është ai që e solli ungjillin në trevat ilire, meriton që të kujtohet në këtë vit jubilar të 2000 vjetorit të lindjes së tij me një simpozium të tillë. Shën Pali apostull i popujve, shpallës i guximshëm dhe tejet i vullnetshëm i solli njerëzimit lajmin e gëzuar të Jezus Krishtit, ndër të cilët një vend të spikatur zënë ilirët dhe trojet tona.*

Në pjesën e dytë të këtij Simpoziumi shkencorë me ligjëratat e tyre u paraqitën: Don Shan Zefi: *Rrethanat religjioze, shogërore, kulturore – filozofike në kohën e shën Palit.* Prof dr Zef Mirdita, i ardhur nga Kroacia ligjëroi në temën: *Fillet e krishterimit në Ballkan me shqyrtim të veçantë ndër shqiptarë.* Pastaj arkeologu ynë i njohur prof dr Jahja Drançolli e shpjegoi temën *Shën Pali në kontekstin historik dhe arkeologjik.* Nga Shqipëria ligjëratën na e dërgoi z Aleksander Meksi, me temën: *Shën Pali dhe fillimet e krishterimit në trojet shqiptare.* Ai nuk mori pjesë në Simpozium për shkaqe objektive.

Në pjesën e tretë u lexua ligjëratat e Imzot Carlo Ghideli, arqipeshkvë, (për shkaqe shëndetësore nuk mori pjesë): *Pedagogjia e shën Palit dhe don Lush Gjergji: Himni i dashurisë – Krishtologjia e shën Palit.*

Salla e Bibliotekës ishte e vogël për t'i pranuar të gjithë të interesuarit.

Shtegtimi në Gjakovë

Romakët e vjetër e përdornin fjalën: *Të gjitha rrugët qojnë në Romë!* Me 28 qershor 2009 për katolikët e Kosovës të gjitha rrugët shkonin në Gjakovë! Me iniciativën e ipeshkvit tonë e nën organizimin e Këshillit Organizativ për vitin e shën Palit u organizua përmbyllja e vitit të shën Palit.

Këtë të diel pas dite, e tërë dioqezja jonë ishte e drejtur kah Gjakova, ku në hyrje të saj u bashkuam të gjithë shtegtarët. Çdo famulli kishte pankartë e pajtorit të famullisë. Në krye të kolonës ishte ipeshkvi ynë Mons Dodë Gjergji, me disa meshtarë e pas tij vinin të rinjtë që mbanin në dorë pankartë me bazilikën e shën Palit, stemën e ipeshkvit, figurën e shën Palit, për të vazhduar me famullitë. Ishin me mijëra besimtarë të të gjitha moshave që shtegtonin drejt kishës së re të shën Pjetrit e shën Palit

me largësi prej më shumë se 2 km. Le të theksojmë pankartën e Nënës Terezë që me dinjitet e krenari e mbante një besimtar nga Llapushniku.

Me mijëra besimtarë kishin hyrë në kishë e po aq ishin edhe jashtë që përmes ekraneve përcillnin mesheën shenjte. Ipeshkvi në koncelebrim me të gjithë meshtarët tanë e filloi mesheën shenjte në ora 17. Të pranishëm në mesheë ishin kryetari i komunës së Gjakovës z Pal Lekaj, me bashkëpunëtorë, përfaqësues ndërkombëtar.

Në pretkun e rastit ndër të tjera ipeshkvi ynë theksoi: *Ne, ashtu si gjeneratat e mëparshme, jemi të vendosur t'i marrim përgjegjësitë tona që burojnë nga Ungjilli i Krishtit dhe pagëzimi ynë.... E dimë të gjithë se Kisha Katolike në të kaluarën është përpjekur me shumë flitje për të ruajtur identitetin tonë shpirtërorë, kulturorë, kombëtarë. Ajo është bërë burim kryesor i vlerave tona të përbashkëta dhe kultivuese të fuqishme e begative tona shpirtërore dhe kombëtare.... E kaluara jonë është Mësuesja më e mira nga e cila duhet të mësojmë të gjithë. Ne në të vërtetë kemi vuajtur shumë, por kemi qëndruar të pathyeshëm në atë që ishim e që jemi tani. Sot fal Zotit, miqve tanë dhe flitimit tonë po gëzojmë lirinë që nuk e kishim kurrë. Sot të gjithë mund të konkurrojmë me vlera dhe me virtytet tona të mirëfillta... Sot secili mund të përcaktohet lirisht në atë që mendon se është e mira e tij. Mbi të gjitha, është hera e parë në historinë tonë, kur secilit i lejohet zgjidhja personale e përcaktimit feta... Falënderoj Zotin që sot në mesin tonë kemi edhe të pagëzuar të ri, të cilët fal lirisë që po e gëzojmë janë kthye kishës dhe fesë së tyre të mëparshme. Të dashur në Krishtin, juve ju pranojmë me gëzim ungujllor të shembullit të Babës së Mirë, i cili e priste djalin e humbur, me dashurinë me të cilën shën Pali ia predikonte Krishtin botës së atëbershme. Ju jeni kthye në shtëpinë tuaj shpirtërore dhe në përvojën tuaj të mëparshme... Ju ftoj të dëshmoni se zgjidhja juaj ka qenë e mirë jo vetëm për ju, por për të gjithë, sepse dashuria është nevojë më e madhe për çdo njeri. Doni ata që ndoshta nuk pajtohen me vendimin tuaj, si dhe ata që ndoshta ju urrëjnë, ashtu siç i donte Krishti ata që e kryqëzonin. Ipeshkvi foli edhe për rëndësinë e familjes dhe rrezikun që i kanosën asaj. Mesheën e përcolli RTK – ja.*

Lavdi Zotit që gjithë çka shkoi dhe përfundoi si është më së miri. Faleminderit Zotit për shën Palin, i cili na e solli Krishtin dhe për hiret e shumta që i kemi marrë gjatë këtij viti jubilar.

Lë ta përfundojmë me konstatimin më të ri të arkeologëve se eshatrat e gjetur në varrin e shën Palit i takojnë njeriut nga shek I, që do të thotë se ka gjasë që të jenë të vetë shën Palit.



Intervistë me artistën Shkurte Fejza në 10 vjetorin e lirisë së Kosovës

Kënga ime është Kosova

Shkurte Fejza, artistja, këngëtarja që la vulë në muzikën popullore. Kënga e saj zgjoi në popull dashurinë për atdheun dhe lirinë.

I këndoi Kosovës, Shqipërisë, Prizrenit, Shkodrës, Manastirit, Mitrovicës, dashurisë, atdheut, lirisë, kullave, fushave e maleve, flamurit dhe vdekjes për liri, të varfërit, Nënë Terezës, Haxhi Zekës, Adem Jasharit, Ibrahim Rugovës dhe e shumë burrave të tjerë që jetuan e vdiqën për liri.

Kënga e saj e pasuroi gjubën e ëmbël shqipe dhe bëri që edhe fëmijët e kurbetçarëve të flasin dhe të këndojnë shqip.

Sa herë u gëzua, u gëzua për Kosovën, sa herë i rrjedhën lotët, i rrjedhën për Kosovën.

Drita: Talenti juaj është i trashëguar apo i mësuar, sepse në Mushtisht ka shumë vajza që këndoj bukur dhe mund të themi se e mbajnë gjallë Kosovën me këngë?

Shkurte FEJZA: Po, e vertetë, Mushtisht është një fshat shumë i bukur që e dua shumë, aty kam lind, jam rrit, jam martu, kam jetu gjatë dhe ende vazhdoj të jetoj kohë pas kohe. Shkoj dhe ndjej shumë kënaqësi kur jam atje. Dhe është shumë e vertetë dhe mund të them: më të mirët e estradës kosovare janë nga ai vend. Tashmë janë të njohur, disa herë i kemi parë edhe nëpër media.

Unë muzikë e kam trashëgim prej familjes, ka kënduar gjyshja ime shumë bukur.

Shkonim shpesh te dajtë bashk me nënën, gjysha më donte dhe më dallonte mua, sepse i dukej se kam trashëguar diçka prej saj. Unë ende e kam të fresket zërin e saj kur ishte 83 vjeqe. Kam pasur disa kaseta të vogëla prej këngëve të saja, mirëpor lufta ndodhi si ndodhi. Kanë qenë kujtimet e mia më të shtrënjta dhe më të shenja që mund ti vlerësoj, por u dogjën.

Këngën e kam trashëguar nga gjysha, pastaj ka vazhduar edhe motra ime e madhe, por pati fatin dhe u martua dhe nuk ka vazhduar më me këtë profesion. Këndojnë dy vajzat e saja Motrat Kryeziu, janë një duet shumë i mirë. Gjithashtu këndon motra ime e vogël Naxhie Fejza edhe tash edhe Gresa, vajza ime. Edhe pse nuk kam dëshirë që edhe ajo të kalojë nëpër vështirësitë që unë i kalova, por ajo ka dëshirë të mirret me muzikë, e

ka shumë për zemër të këndoj.

Ndërsa djali nuk këndon, ai i bjen kitarës. Ka shije të hollë për muzikë, këndon vetëm për vete.

Drita: Tekset e këngëve ku i merrni apo i shkruani edhe vet dhe që sa vite këndoni?

Shkurte FEJZA: Ndonjëherë marr guximin tekset t'i shkruaj edhe vet, si është kënga Djali i Dukagjinit dhe ndonjë tjetër. Por në përgjithësi nuk e kam atë guxim, më shume i preferoj poetët e ndryshëm të cilët përmblen shprehjet e tyre me poezi dhe me poezinë e tyre te bukur. Kohëve të fundit kam një bashkpunim shumë të mirë me Faruk Tashollin, i cili jeton në Gjermani. Është një poet shumë i mirë. Temat të cilat unë i perferoj ia percjelli e ai me përkushtim të madh i realizon. Deri tani kam realizuar mbi 400 këngë.

Këndoj që nga fillimi i vitit 1975, kur për herë të parë kam dalë në skenën e festivaleve në Prizren, Takimet e Majit, në atë kohë. Dhe nëse mirret si datë atëherë që 34 vite.

Drita: Kënga e juaj ka zgjuar në popullin tonë atdhe-dashurinë. Kënga juaj i ka bërë njerëzit ta duan Kosovën. Më kujtohem mua kur në ato vite të largëta, vinte ndonjë këngëtar nga Serbia apo nga një vend tjetër, sallat u mbusheshin përplotë me dëgjues shqiptar. Dhe ju po në atë kohë dolët në skenë dhe i drejtuat mbarë të gjithë ata njerëz. A keni qenë të vetëdijshëm për gjithë këtë punë?

Shkurte FEJZA: Vlerësim shumë i mirë ky, e dua dhe më

pëlqen kur më thonë kështu.

Unë këtë gjë e kam bërë me vetdije dhe jam shumë e kënaqur që këtë e kam arritur, ta bëjë një punë të mirë, që të ngritet vetëdija, sidomos tek të rinjtë e atëherëshëm. Unë ende vazhdoj t'i këndoj Kosovës. Kosova për mua është inspirim dhe burim i pashtershëm.

Unë nuk di si të këndoj ndryshe. Janë aty këtu disa këngë që kanë hyrë në repertoar si këngë ahenjesh dhe dasmash. Por edhe ato janë të domosdoshme, sepse edhe dasmat janë pjesë e jetës. Megjithatë unë nuk di të këndoj ndryshe. Po nuk pata këngë për Kosovën, mendoj që nuk kam bërë punë me vlerë. Andaj këtë punë e kam bërë me vetëdije të plotë, dhe e falënderoj Zotin që ma dha talentin që me anë të këtij zëri t'i shërbej popullit tim, dhe nëse ju e vlerësoni dhe të tjerët thonë se ke komplementet nga me te bukurat, unë ndihem shumë mirë, dhe shpesh ngrihem nga vendi e them: O Zot ishalla është kështu.

Drita: Ju me këngën tuaj e keni pasuruar gjubën shqipe, keni dhënë një kontribut të madh që kjo gjuhë të flitet më bukur dhe më rrjedhëshëm.

Shkurte FEJZA: Jo, këtë nuk e di. Kjo është natyra e të folurit tim megjithëse ndoshta ka ndikuar që unë kam punuar edhe në arsim. Kam qenë mësuese. Dhe kjo besoj ka ndikuar në pasurimin e gjuhës. Natyrisht që këtë e ka bërë bashkpunimi me emra të dëshmuar të muzikës shqiptare, me kompozitor të mirënjohur dhe kjo punë ta imponon një vlerë që ti e pranon. Vetvetiu përderisa

“ Unë jam pjesë e këtij populli, kam jetuar dhe jetoj kohën të cilën e ka kaluar ky popull, dhe natyrisht nuk mund të këndoj ndryshe. Vet rrethanat ta imponojnë temën. Nuk mund të jesh indiferente ndaj asaj që po ndodhë. ”

punon me njerëz që kanë vlerë, ti ke vlerë. Për këtë gjithmonë kam pasur kujdes. Kam këngë të Pjetër Gacit. Si mund të jetë ndryshe kënga e Pjetër Gacit, pos me vlerë, bukur e shkruar, bukur e kompozuar. Natyrisht se edhe unë kam ndier obligim të ja jap hakun, ashtu si ai e ka kompozuar. Pastaj kam këngë të Kolë Susajt, i cili i ka bërë hitet më të mëdha shqiptare, dhe gjithësesi ndjen obligim, dhe nuk ndihesh mirë nëse ti nuk shkon së paku në atë kategori, me ju dhanë hakun. Ashtu si ai është ulur dhe ka punuar me atë këngë, ashtu me përgjegjësi e kam kënduar këngën. Kjo ka bërë që unë të jam më e përgjegjshme ndaj punës sime dhe ndaj kompozimeve që kam marrë. Dhe mund të ndodhë që e meritoj këtë vlerësim që ju ma thuani për kontributin tim për Gjubën Shqipe.

Gjithashtu bashkpunimi me kompozitorin Naim Gjoshin, e ka pasuruar mjaft repertoarin tim. I ka bërë nder krijimtarisë sime. Tash, kohëve të fundit e kam realizuar një këngë për Ibrahim Rugovën, të kompozuar nga z.Gjoshi me tekst të Faruk

Tashollit. Mendoj se është një këngë shumë e mirë, kam punuar shumë, mendoj se ja kam arritur qëllimit.

Drita: Kënga e Shkurtës është shkollë e patriotizmit, shkollë shpirtore dhe shkollë gjuhësore. Ju i keni kënduar dashurisë, atdheut, lirisë, kullave, fushave, maleve, zogut që vajton, Kosovës, Prizrenit, Manastirit, Shkodrës, të varfërve, kurbetit, vajzave, flamurit, vdekjes për liri, pavarësisë dhe shumë personaliteteve.

Shkurte FEJZA: Faleminderit! Më nderon vlerësimi juaj. Kthehem edhe një herë te teksti, sepse është punë shumë e ndjeshme, nuk mund t'i këndosh një njeriu të madh siq ishte Rugova, me një tekst tendencioz, që nuk i shkon natyrës së tij. Kam kërkuar tekste, por nuk u kënaqa me ato. Dhe në bashkpunim me Farukun ma mundësoi. I thash: kërkoj një tekst për Ibrahim Rugovën, që aty ta shoh Rugovën, jo tendencioz, por ashtu si ishte. Teksti të mos jetë ngac-

mues por ashtu siq e e meriton ai, Jam e kënaqur.

Unë jam pjesë e këtij populli, kam jetuar dhe jetoj kohën të cilën e ka kaluar ky popull, dhe natyrisht nuk mund të këndoj ndryshe. Vet rrethanat të imponojnë temën. Nuk mund të jesh indiferente ndaj asaj që po ndodhë.

Si artist i ndjen ato gjëra më shumë, sepse ndjesia te artist është më e theksuar.

Drita: Pas vitit 1999 tek ju më shumë është e theksuar lirika.

Shkurte FEJZA: Po natyrisht, sepse një krijues e ndjen atë, dhe e jeton atë dhe vetvetiu lindë krijesa shpirtërore dhe këndon atë që është akutale për vet popullin. Këndon për ato gjëra që e mundojnë atë popull. Neve na ka munguar liria dhe i kemi kënduar lirisë së Kosovës, vuajtje. Tani është pak më ndryshe, e kemi një copë liri.

Gjithmonë, e kam burimin të pashtershëm Kosovën. Gjithmonë i këndoj Kosovës. Është një temë që shumë e gjatë, kurr nuk hargjohet. Nuk e kam problem të gjejë tema.]

Falë Zotit, me shëndet jam mirë, edhe me zërin jam mirë, duhet gjithmonë të përsoset puna. Të ndjeni kërkesat, shija të

jetë më e hollë dhe të shkon deri në përsosmëri. Ambiciet vdesin kur vdes njeriu.

Drita: Muzika për ju gjithmonë ka qenë art, dashuri dhe mesazh për popullin e Kosovës. Për çfarë muzike kemi nevojë ne si popull i Kosovës?

Shkurte FEJZA: Unë mendoj se populli i Kosovës edhe në muzikë ka nevojë t'i kthehet vetvetes. T'i kthehet traditës. Jo në kuptimin të kthehet mbropa. Por të nisët nga tradita sepse është shumë e pasur. Më duket se po hyjmë në gjynah me vetvetën, duke e shkelë vetvetën, duke e lënë anash traditën tonë, pasurinë tonë kombëtare. Mund të them se shumë popuj na kanë zili. Ky vrap mbas të resë botërore i ka hutuar të rinjtë. Duhet të kemi një masë. Jo ta mohosh vetvetën assesi. Mendoj se nuk ka asnjë popull në botë që e ka folklorin më të pasur se populli ynë. Kultura e popullit tonë është një det i gjerë që nuk shterret kurrë. Më iritojnë vrapimet pas asaj që është e huaj. Kjo është e dëmshme, Por rrëmuja që u krijua tek ne në çdo aspekt, ka krijuar një hapsirë të tillë që njerëzit me antivlera dhe me mundësi të madhe materiale të imponohen. Askush nuk i ka në kontrollë,

askush nuk ua prish. Askush nuk ju turbullon ujin. Për këtë më së pakti kemi nevojë. Për mua shpirtërore është të këndoj shqip. Të këndoj këngë të popullit tim, të kultivoj këngën e mirëfilltë burimore shqiptare. Sepse ky popull e don këtë këngë. Kot mundohen disa njerëz ta injorojnë, muzika popullore shqiptare ta kënaqë shpirtin edhe ta ngacmon. Kur e ndjen reagon. Mendoj se është e domosdoshme të jemi vetvetja.

Drita: Këtë intervistë që e bëj me juve është në 10 vjetorin e lirisë së Kosovës. Ju i kënduat më së shumti lirisë dhe pavarësisë së saj. Çka ju ka shtyer të këndonit kaq shumë?

Shkurte FEJZA: Kam kënduar sepse e kam dëshiruar një ditë të tillë dhe jam shumë e lumtur që e kam arritë. Përkundër sakrificave që i kemi pasur, megjithatë konsideroj vetën se jam njeri me fat që kam pasur mundësi ta shijoj, ta prekë këtë liri, të cilën i kam këndu gjatë gjithë jetës sime, dhe do vazhdoj ti këndoj. Kam pasur lëvizje, konfekte me njerëz të ndryshëm të cilët kanë pasur dhe kanë dhimbje, ata që e kanë shijuar me kamatë këtë liri. Më dhemb shpirti kur takoj njerëz që më pak e shijojnë këtë. Ata që e kanë paguar më shtrejtë, dhe nuk është e njëjtë pavarësisht deklaratës që e bëjnë: "Ne jemi krenarë e jemi të kënaqur" mirëpo brendia ime më thotë diçka tjetër. Unë edhe me ta e kam ndarë dhimbjen. Mirëpo edhe me ata që janë gëzu e kam ndarë gëzimin. Edhe unë jam pjesë e kësaj dhimbje, vëllai i shokut tim Azem Behluli, u vra në front. Udhë unë jam pjesë e kësaj dhimbjeje. Uroj që ky popull të di të menagjoj me lirinë dhe të punojnë për të mirën e Kosovës.

Drita: Ju jeni ikonë e lirisë?

Shkurte FEJZA: Falëminderit, unë vetëm e kam bërë punën time, dhe kisha pas dëshirë ta bëjnë të gjithë punën e vet. Unë edhe një herë e falënderoj Zotin që ma dhuroj zërin dhe pata mundësi të kontribuoj për Kosovën, dhe dëshiroj që të gjithë njerëzit që kanë një profesion, një mundësi, një prirje, një talent, t'a përdorin për të mirën e Kosovës. Secili njeri të punon në profesionin e vet, aty ku shkelqen, që të mund të jap kontribut më të madh për shtetin tonë.

Drita: Roli i juaj si nënë, i këndonin nënës, fjala juaj për nënën?

Shkurte FEJZA: Të jesh nënë është privilegj, diçka e shenjtë, diçka që të vjen keq që gjinia e kundërt nuk mund ta përjetojnë. Singlerisht është diçka që nuk mund të ja përshkruaj dikujt. Por të jesh nënë është gjithashtu edhe sakrificë, ngarkesë, tmerrësi, dhimbje, është një ndjenjë shumë e mirë kur ti ke mundësi



të falësh dashurinë. Është përgjegjësi të rritësh fëmijë, do krijosh njerëz që do përballen me jetën. Të krijosh një njeri është shumë vështirë dhe shumë e mundimshme, dhe nganjëherë mendon se nuk ja kë dalë si nënë. Atëherë kur njeriu hasë në probleme të fëmijëve dhe duket se femija nuk ishte i fortë t'i përballon, menjëherë ti fajin ja lë vetit. Unë kam vërejtje për veten se nganjëherë më duket si nënë kam munguar të fëmijët e mi. Kjo më dhemb, është kohë që nuk kthehet. Profesioni im ishte i tillë. Kontributin tim për Kosovën fëmijët e vegjëll nuk e kuptonin, ata kishin nevojë ta kanë afër nënën. Tash si të rritur e kuptojnë mirë. Unë prap e falënderoj Zotin që fëmijët i kam të mirë, janë nxënës të mirë, student të mire, dhe janë të mbarë.

Drita: Po aborti?

Shkurte FEJZA: Aborti është temë që krijon dhimbje të mëdha, është një krim. Gjendja ekonomike dhe rrethanat e shtynë një nënë të bëjë një gjë të tillë. Mendoj se duhet të falet nëna sepse askujt nuk i dhemb më shumë se asaj. Por një nënë nuk ja falë vetvetës këtë dhe kjo ndjenjë do ta përcjellë gjatë gjithë jetës.

Drita: Kur keni pasur gëzim të veçantë në jetën tuaj?

Shkurte FEJZA: Lindja e fëmijëve është diçka e veçantë, është diçka hyjnore. Pastaj sukseset e fëmijëve të japin gëzim. Kthimi ynë nga Shqipëria, kur u lirua Kosova, ishte një gëzim i

madh, i pa përshkrueshëm, sepse kur e lëshuam Kosovën menduam se çdo gjë mori fund, e kthimi ishte një lindje e jona e dytë kur edhe një herë e shkelëm tokën e Kosovës së lirë.

Drita: Kjo liri që e kemi tani e shijojmë a është ajo liri që e keni ëndërruar dhe i keni kënduar gjithmonë?

Shkurte FEJZA: Lirinë e kam ëndërruar më ndryshe, kam ëndërruar se si popull do të bëjmë më shumë për Kosovën. Çdo ditë e shijoj këtë liri, gati e preki me dorë. Ndonjëherë më bien ndërmend ditët e tmerrshme dhe ngjarjet e Reqakut e Prekazit, nuk i harroj dot lotët e këtij populli. Por lirinë e shijoj çdo ditë, çdo mëngjes e çdo mbrëmje.

E falënderoj Zotin që e shpëtoi këtë popull.

Drita: Cila do të jetë kënga juaj jetësore?

Shkurte FEJZA: Mendoj se çdo këngë që e këndoj, e këndoj mirë. Kam kënduar një këngë për Adem Jasharin, dhe mendoj se kam lënë vulën time. I kam kënduar Kosovës dhe kam marrë shpërblimin e njerëzve që e kanë dashur këngën time. Kanë kënduar bashk me mua. Kjo është për mua jetësore. Tash kam bërë një këngë për presidentin e parë të Kosovës Ibrahim Rugovën. Mendoj se edhe aty qëndron një firmë e imja, një vullë e vogël.

Por kënga **Oj Kosovë oj nëna ime**, mendoj se s'do të harrohet kurrë.

Intervistoi:
Pater Ndue Kajtazi



Shën Pali dhe fillimet e krishterimit në trojet e sotme të shqiptarëve

■ SHKRUAN:
Aleksandër MEKSI

Për historinë e vendit tonë studimi i kohës dhe i rrugëve të futjes së fesë së krishterë si dhe Apostujt e misionarët që e propaganduan, punuan, luftuan dhe pranuan martirin për këtë qëllim, paraqet interes të veçantë sepse në këto shekuj të parë u bë një ndryshim rrënjësor në besimin fetar si dhe në gjykimin për vlerat e shoqërisë njerëzore, në kulturë e art.

Kërkime të shumta të viteve të fundit nga studiues shqiptarë dhe të huaj të mbështetur në burimet historike dhe ato kishtarë, kanë ndriçuar së tepërmi problemën e fillimit të krishterimit në trojet e sotme të shqiptarëve dhe rolin e Apostullit Pal në këtë drejtim. Po përmendim këtu ndër të tjerë për kontributin e tyre Kristo Frashërin, Zef Mirditën, Gaspër Gjini, Shaban Sinanin, Dhorë Qirjazin e Thanas Gjickën, pa qendruar në këtë kumtesë në shtjellimin dhe përfundimet e kërkimeve të tyre, kur nuk jemi të një mendje me ta.

Të dhënat që janë në *Veprat e Apostujve*, shkruar nga Ungjillori Luka dhe letrat e Shën Palit, paraqesin për ne materiale të mjaftueshme, edhe pse janë jo të hollësishme, duke qenë ky cilësim relativ, ngaqë njohim vetëm letrat që kanë mbërritur deri në ditët tona. Të dhëna të tjera të traditës kishtarë, që disponohen mund të quhen të mjegullta dhe fare të pakta apo dhe të mëvonshme, por me gjithë këtë nëse studiohen me vëmendje dhe kriterë shkencorë e pa paragjykimë të çdo lloj qofshin, ofrojnë mundësinë për të pasur disa përfundime të padiskutueshme dhe me vlerë.

Trojet e sotme të shqiptarëve në atë kohë, të përfshira në perandorinë romake, ishin administrativisht në provincën e Maqedonisë dhe ato në veri të krahinës së Lezhës dhe Dardania në provincën e Ilirikut. Le të shohim të dhënat historike që disponohen për shtrirjen e provincës së Maqedonisë në shekullin e parë, për të qenë më të saktë në parashtrimet tona. Studiuesi më i njohur për Historinë e Romës Teodor Mommsen na kumton se në kohën republikane duket se edhe Scodra ishte në Maqedoni dhe se lumi Drin ishte kufiri i kësaj province. Po kështu dhe Epiri nuk bënte pjesë në Greqi dhe se dhe veriu i Epirit ishin përfshirë në Maqedoni. Pra, pjesa më e

madhe e trojeve të sotme të banuara nga shqiptarët, ishte gjatë shekullit të parë të erës së re në Provincën e Maqedonisë. Në këto troje krishterimi, siç vërehet ndër të tjerë veçanërisht Zef Mirdita dhe Kristo Frashëri, të cilët e kanë trajtuar më me hollësi këtë çështje, si në paraqitjen e burimeve, ashtu edhe në aspekte të veçanta, u përhap në të njëjtën periudhë kohore që u përhap në Itali dhe Greqi, dhe po ashtu në kushte të vështira dhe përndjekjeje nga pushteti perandorak.

Dëshmia më e vjetër dhe e njëkohshme me fillimet e përhapjes së fesë së re dëshmohet në letrat e Apostullit Pal dhe "*Veprat e Apostujve*" të njëkohshme me to. Të dhëna të tjera historike, të mëvonshme por që e kanë origjinën në traditën apo kujtesën historike të vetë kishës, d.m.th. të etërve dhe të dinjitarëve të saj, sigurisht që na ndihmojnë në këtë drejtim. Të gjitha këto dëshmi edhe pse të themi copëza, shërbejnë, po të interpretohen me vëmendje dhe paanësi, për të plotësuar kuadrin historik.

Në letrën drejtuar bashkësisë së krishterë në Romë, shkruar siç kuptohet gjatë qëndrimit të Shën Palit në Korint (vitet 57-58), pra në kohën e udhëtimit të tij të dytë për predikimin dhe përhapjen e fjalës së shenjtë, Apostulli thotë ndër të tjera: "...se kështu, prej Jerusalemit e përqark dhe gjer në Ilirik kam kryer shërbimin e Ungjillit të Krishtit, duke u përpjekur të ungjillëzoj atje ku nuk ishte i njohur emri i Krishtit (Romakëve 15,19)". Ka pasur dhe ka ende diskutime të shumta për kuptimin e fjalëve *gjer në Ilirik* (μὲχρι τοῦ Ἰλλυρικου). Për disa kemi të bëjmë me Ilirikun si kufi të vajtjes së vetë Shën Palit, për të tjerët se ai u fut edhe në Ilirik. Vërejmë se këtu nuk duhet të ngatërrojmë Ilirinë si vendi i ilirëve me provincën romake të Ilirikut, në të cilën, me organizimin territorial të perandorëve romakë të asaj kohe u përfshi vetëm një pjesë e trevave ilire, saktësisht nga Lisusi (Lezha) në Dalmaci dhe Kosovën e sotme.

Sido që të jetë, Shën Pali dhe pasuesit e tij ose më saktë di-shepujt e tij që e shoqëronin në këto udhëtime ungjillëzimi apo lëviznin në këto vende, predikuan ungjillin e Krishtit edhe në ilirik. Për këtë Shën Pali flet në letrën e dytë drejtuar Timotheut ku i shkruan se Titi ka shkruar në Dalmaci (2 Timotheut 4,10).

Akoma më me interes janë për temën tonë, siç kanë treguar



“...se kështu, prej Jerusalemit e përqark dhe gjer në Ilirik kam kryer shërbimin e Ungjillit të Krishtit, duke u përpjekur të ungjillëzoj atje ku nuk ishte i njohur emri i Krishtit (Romakëve 15,19)”

edhe studiues të tjerë shqiptar, të dhënat për udhëtimet dhe qëndrimin në Maqedoni të vetë Apostullit Pal, i cili ndërmori disa udhëtime dhe qëndrojë periudha të gjata atje dhe Greqi (Akaj). Për ne është më se e qartë se, pavarësisht se në letrat e tij apo dhe në "*Veprat e Apostujve*", përmenden vetëm disa qytete, në të cilat ai qëndroi gjatë këtyre udhëtimitve së bashku me pasuesit e tij,

vetë misioni i tij sigurisht që e ka shtyrë apo detyruar të lëvizte, atë si dhe pasuesit, kudo që mundej për të predikuar Ungjillin e Krishtit dhe të krijonte bashkësi të krishtera e me vonë të takonte vëllezërit dhe motrat e tij në fe, që duhej të ishin dhe mbështetja e tij në këto udhëtime e qëndrimi me që nuk shiheshim me sy të mirë nga njerëzit e perandorisë dhe vendasit e pakonvertuar.

Për Maqedoni, që si provincë krijohet në mesin e shekullit të dytë para Krishtit, në këtë kohë kuptohen edhe trojet në jug të Drinit pra pjesë të Ilirisë, Thesalia, pjesë të Thrakës edhe deri Epiri. Maqedonia zë një vend me rëndësi në punën misionare të Shën Palit, ai shkoi dy herë në mision në Maqedoni duke predikuar dhe takuar bashkësi të krishtera. Ai përshkroi vise

të tëra të Maqedonisë ku kup-tohet se bënin pjesë edhe trojet e banuara nga ilirët. Në fund të udhëtimit të tretë ai i shkruan Titit (Titit 3,12) që të vij ta takojë në Nikopojë ku kishte vendosur të kalonte dimrin.

Prania e Shën Palit në territoret e Maqedonisë të atëherëshme së bashku me shoqëruesit e tij, ndër ta po përmendim Titin dhe Apolin, që Le Quien e rendit si peshkop të Durrësit, janë të mjaftueshme për ne, për të lidhur, fillimet e ungjillëzimit të banorëve në trojet e sotme të shqiptarëve me emrin e tij dhe të pasuesve të tij.

Këto të dhëna konfirmohen dhe nga historian të shquar që kanë jetuar në antikitet, ndër ta Shën Jeronimi, i cili, kur flet për ata që përhapën krishterimin në territorin e perandorisë romake, për këto troje thotë se e përhapin Shën Pali. Me interes të vërejmë këtu se shumë shekuj më vonë Marin Barleti lidh me emrin e Shën Palit gjurmë që takohen në këto krahina.

Një vend më vete dhe me rëndësi për temën që po shqyrtojmë zë përfundimi me shumë rëndësi i Kristo Frashërit i cili, njëson me Cezarin peshkopin Dyrrahut, siç e tregon Farlati në vëllimin e shtatë të *Illyricum Sacrum*, pra personin që përmend Shën Pali në letërn drejtuar Filipianëve (Filipasve 4,22): “*ju përshëndesin gjithë shenjtoret, sidomos ata nga shtëpia e Cezarit*”. Sipas burimeve ku mbështetet edhe Farlati Cezari është një nga “*të shtatëdhjetët*” dishepuj të Krishtit dhe peshkopi i parë i

Dyrrahut.

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të parë dhe në kapërcyellin e këtij shekulli ka dhe emra të tjerë që përmenden si peshkop apo shenjtore që martirizohen për fenë e krishterë. Më i njohuri ndër ta është Asti peshkop i Durrësit që festohet më 7 Korrik i martirizuar në mënyrë çnjerëzore gjatë përndjekjeve që filluan me perandorin Traian dhe vazhduan më tej. Ai vdiq gjatë vitit rro, së bashku me të tjerë të krishterë të ardhur aty nga Italia Peregrinos, Lucianos Hesychnus, Pompejus, Saturninus, Papjus dhe Germanius.

Nga këto vite kanë ardhur deri tek ne emrat e tre peshkopëve të Dyrrahut *Cezari, Apoli (?)* dhe *Asti* çka dëshmon për një bashkësi të rëndësishme që zë fill me vitet e përhapjes së krishterimit nga Shën Pali dhe pasuesit e tij. Këtu shtojmë se nuk kemi asnjë dëshmi të drejtpërdrejtë për qëndrimin apo kalimin e tij në Dyrrah, veç se hipoteza, për ne të kërkuara me dëshirë të mirë, por që nuk vërtetohen nga dokumentacioni historik dhe për këtë ne nuk po debatojmë këtu. Vlen të përmendim se ndër të “*shtatëdhjetët*” e Jezuit në një listë shënohet dhe *Hermas-Hermius*, peshkop në Dalmaci.

Veprimtaria misionare e Apostullit Pal dhe e pasuesve të tij për përhapjen e Fjalës së birit të Perëndisë krijoi bashkësi të shumta të krishtera në territoret që ata vizitonin. Dëshmi e kësaj janë njoftime për peshkop apo shenjtore që martirizohen më vonë. I tillë ishte rasti i Shën

“ Veprimtaria misionare e Apostullit Pal dhe e pasuesve të tij për përhapjen e Fjalës së birit të Perëndisë krijoi bashkësi të shumta të krishtera në territoret që ata vizitonin. Dëshmi e kësaj janë njoftime për peshkop apo shenjtore që martirizohen më vonë. I tillë ishte rasti i Shën Astit në Dyrrah. Shembuj të tjerë kemi Shën Florus dhe Shën Laurus, dy vëllezër gurskalitës që përkujtohen më 18 Gusht të martirizuar në Ulpianë të Dardanisë gjatë shekullit të dytë. ”

Asti në Dyrrah. Shembuj të tjerë kemi Shën Florus dhe Shën Laurus, dy vëllezër gurskalitës që përkujtohen më 18 Gusht të martirizuar në Ulpianë të Dardanisë gjatë shekullit të dytë. Po kështu kemi më vonë *Isaurus* diakon, *Innocentius, Felix, Basilos e Peregrinos*, athenas të martirizuar në Apoloni e që përkujtohen më 17 Qershor. Një e dhënë tjetër është shembulli i senatorit *Philetus* që martirizohet në Ilirik së bashku me gruan dhe fëmijët e të tjerë e që përkujtohet më 22 Nëntor. Një emër i shquar ndër martirët e krishterë është dhe Shën *Eleuteri (Liberatori)* me të emën *Antia* që martirizohen

gjatë sundimit të Adrianit. Ai ishte sipas shkrimeve të vona peshkop në Ilirik. Të fundin po përmendim këtu Shën *Therion* që u martirizua në Buthrot rreth mesit të shekullit të tretë gjatë sundimit të *Decius*.

Kërkime më të hollësishme, në botimet e specializuara si dhe në *Martirologjet romane* dhe *Menologjet greke*, mund të ofrojnë të dhëna të tjera që të gjitha bashkërisht konfirmojnë mendimin mbizotërues për krishterimin e hershëm në trojet e sotme të shqiptarëve. Siç vëren Kristo Frashëri ndër ne krishterimi u përhap si tek grekët dhe romakët që në fillim dhe nga poshtë lartë

në luftë, apo në kundërvënje me pushtetin perandorak. Në favor të kësaj teze se krishterimi është përhapur herët është edhe terminologjia kishtare më e vjetër e gjuhës shqipe që rezultojnë e huazuar nga latinishtja.

Ndër studimet e shumta për përhapjen e fesë së krishterë në këto territore janë dhe dy monografi të me autorë Zef Mirditën dhe Radomir Popović (deri në ardhjen e sllavëve). Besoj se nuk ja vlen të zgjatemi për të kundërshtuar Schramm që krishterimin në këto treva e prunë duke ardhur nga veriu në një periudhë më të vonë besët dhe se ata janë të parët e shqiptarëve. Sidoqoftë e gjykojmë të nevojshme ndërmarrjen e studimeve që lidhen me historinë e krishterimit ndër iliro-shqiptarët: fillimet, përhapja, organizimi administrativ e të tjera aspekte historike e të dogmës, që do të përbënin një kontribut me vlerë për historinë e vendit tonë.

Për të përfunduar këtë trajtesë, për ne të mbështetur mbi dokumentacionin e pranuar nga të gjithë, të dhënat e traditës së kishtare, si dhe kontributin e studiuesve që na kanë paraprirë, me gjithë pasaktësitë eventuale dhe mospërputhjet, shprehemi se jemi të bindur që *ishte Shën Pali dhe pasuesit e tij ata që në trojet e sotme të shqiptarëve përhapën krishterimin*, pa ju trembur përndjekjeve dhe duke pranuar martirin, për të dëshmuar besimin e tyre në Fjalën e Birit të Perëndisë, të Jezu Krishtit. Dëshmi e përmasave të përhapjes dhe të rrënjeve të thella të besimit të ri jan, pas lejitimit të fesë së krishterë, dhe monumentet e shumta të periudhës paleokristiane dhe institucionalizimi i menjëhershëm i strukturave të kultit në këto territore. Po kështu dhe pjesëmarrja e prelatëve të kishës vendase në koncilët e ndryshme dhe përfshirja e tyre në debatet e kohës.

Tiranë, 2 Maj 2009



“Arka e Besëlidhjes” në Jerusalem...

“SI DO TË HYJË TEK UNË ARKA E ZOTIT?” (2 Sam 6, 9)

■ SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

“Arka e Besëlidhjes” është një ndër emërtimet e litanive lauretiane kushtuar Virgjërës Mari. Prokleo, patriku i Kostantinopojës, në shekullin e V pas Krishtit thotë për Marinë kështu: “*Maria është nënë, shërbëtore, arka e Zotërisë*”.

Romano Melone (shekulli VI pas Kr.) për Zojën e Bekuar shkruan kështu:

“Ajo është Arka e Besëlidhjes, e cila në vete ka apo bart vetë Zotin”.

Gjon Damasheni pohon:

“Maria është nëna e të gjithë besimtarëve, arkitekti dhe ndërtimeari është vetë Zoti”.

Davidi, së bashku me mbarë popullin e Izraelit, e morën Arkën e Besëlidhjes duke e përcjellë atë me këngë, vallëzime dhe hare (krh. 2 Sam 6, 1-5) dhe e vendosën në shtëpinë e Obedom Gedeut për tre muaj.

Zoti e shpërbleu atë për pranimin dhe mikpritjen e Arkës me të mira dhe bekime të shumta.

Më vonë mbreti David e mori Arkën e Besëlidhjes “*në qytetin e Davidit me gëzim të madh*” (2 Sam 6, 12).

Çfarë rëndësie kishte Arka e Besëlidhjes për popullin e Izraelit?

Gjatë pushtimit dhe marrjes apo hyrjes në Tokën e Premtuar, nga Arka e Besëlidhjes vetë Zoti – Jahwe e udhëhiqte ushtrinë dhe popullin. Nëse populli mëkatonte, jepej pas idhujtarisë, atëherë Zoti largohet prej popullit të vet dhe Arka binte në duar të armiqve /lexo: 1 Sam 4-6).

Gjatë këtij shtegtimi të shenjtë, ndodhi një befasi e pakëndshme dhe ndëshkim i rëndë.

“*Oza shtriu dorën e vet nga Arka e Hyjit dhe e mbajti, sepse qetë, duke u ngutur, gati e rrëzuan. Por fëlgrimi i Zotit u ndez kundër Ozesë dhe e goditi për shkak të guximit të tepruar dhe vdiq aty përskaj Arkës së Hyjit*” (2 Sam 6, 6-7).

Kjo ngjarje tragjike dëshmon transcendencën, shenjtërinë e

“Çdo i krishterë pas takimit, afrimit dhe bashkimit me Zotin nëpërmjet Eukaristisë, kungimit, ka për detyrë që atë t’ua “bartin” edhe te tjerëve, si Arkën e Zotit, si Maria në pasi te Elizabeta, duke zgjuar te të tjerët shqetësim, kërkim, admirim, nevojë dhe dëshirë për Jezu Krishtin.”

Zotit dhe të Arkës së Besëlidhjes, gjë kjo që shkaktoi huti dhe frikë të të gjithë, edhe te Davidi i cili thotë:

“Si do të hyjë tek unë Arka e Zotit?” (2 Sam 6, 9).

Ky shtegtimi i Arkës së Zotit ndërlihet me shtegtimin e Marisë te Elizabeta.

Udhëtimi i Arkës është një lëvizje.

“Davidi u ngrit dhe shkoi...” (2 Sam 6, 1).

“Ndër ato ditë Maria u nis me nxitim...” (Lk 1, 39).

Këto dy udhëtime dhe shtegtime i përcolli një gëzim i madh (krh. 2 Sam 6, 12);

Për Elizabetën dhe birin e saj ende në krahavaror thuhet kështu:

“Ja, se, posa zëri i përshendetjes sate arriti në vesh të mi, foshnja prej hareje kërcëu në krahavarorin tim” (Lk 1, 44).

Arka e Besëlidhjes bartet në qytetin e Davidit (krh. 2 Sam 6; Maria ngutet në krahinën malore në një qytet të Judës (krh. Lk 1, 39-45).

Davidi para Arkës së Zotit thotë:

“Si do të hyjë tek unë Arka e Zotit?” (2 Sam 6, 9);

Elizabeta para Virgjërës Mari thotë:

“Dhe, nga e pata fatin të vijë tek unë Nëna e Zotit tim?” (Lk 1, 43).

Kjo ndoshta edhe është pika qendrore dhe kulmore e përputhshmërisë mes Arkës së Zotit dhe Virgjërës Mari, sepse Arka ishte “selia” e pranisë së Zotit në mesin e popullit, ndërsa Maria është “selia” e pranisë së Jezu Krishtit, Zot dhe Njeri, Shëlbuesit të mbarë njerëzimit, i cili të mishërohet mu nëpërmjet saj.

Kemi edhe një paralelizëm

kohor:

Arka e Zotit qëndron tre muaj në shtëpinë e Obedom Gedeut (krh. 2 Sam 6, 10), si dhe Maria ishte afro tre muaj në shtëpinë e Zakarisë (krh. Lk 1, 56).

Te Davidi shprehen frika, tmerr, shqetësimi për bartjen e Arkës së Zotit, te Elizabeta ndërimi, admirimi, habia, por edhe gëzimi i pamashë për praninë e Marisë, nëpërmjet saj për praninë e vetë Zotit.

Prania e Zotit – SHEKINAH – në Arkën e Besëlidhjes dhe në Virgjërën Mari ishte për të tjerët, për të gjithë: te Arka e Zotit për të zgjedhurit e Izraelit, tridhjetë mijë vetë (2 Sam 6, 1), te Zonja Mari për mbarë njerëzimin (krh. Lk 1, 43-44).

Shën Gregori Nazianzenas thotë se Virgjëra Mari është “Temulli i pastër i Zotit” me dy trajta;

nëpërmjet natyrës njerëzore, që Jezusi e mori nga krahavori virgjëror i Marisë, Arkës së Besëlidhjes, me fuqinë dhe ndikimin e Shpirtit Shenjt virgjëra mbetet shtatzënë;

nëpërmjet natyrës njerëzore zbulohet, shpallet, dëftohet dhe dëshmohej hyjnia e Jezu Krishtit.

Shi për këtë Virgjëra Mari është kryevepra e Shpirtit Shenjt në planin e shëlbimit, modeli i përsosur i bashkëpunimit me hirin e tij.

“Arka e Besëlidhjes” gjatë his-



torisë është Kisha Katolike, siç e quan edhe Koncili i Dytë i Vatikanit “sakramenti i shëlbimit”, ajo që e shpallë Lajmin e Gëzuar, Ungjillin, atë ua ofron dhe dhuron të gjithëve nëpërmjet sakramenteve dhe dëshmisë së krishterë. Ajo është “*Nëna dhe Mësuësja*” si thoshte Gjoni XXIII-të, e cila na lindi për Zotin, për bashkësinë e krishterë, na mëson dhe edukon, ushqen me sakramente, veçmas me Eukaristinë, Bukën e Jetës dhe pengun e shëlbimit.

“Arka e Besëlidhjes” është çdo i krishterë i cili jeton në hirin e Zotit, është i Zotit, dhe atë e dëshmon dhe dhuron të tjerëve nëpërmjet jetës së krishterë.

Çdo i krishterë pas takimit, afrimit dhe bashkimit me Zotin nëpërmjet Eukaristisë, kungimit, ka për detyrë që atë t’ua “bartin” edhe te tjerëve, si Arkën e Zotit, si Maria në pasi te Elizabeta, duke zgjuar te të tjerët shqetësim, kërkim, admirim, nevojë

dhe dëshirë për Jezu Krishtin.

Nëse jemi me Krishtin dhe të Krishtit, atëherë s’mund të jemi pasivë, në gjumë apo në kllapi, por gëzimin, harënë, lumturinë, jetën dhe dashurinë që e kemi gjetur në Të dhe nëpërmjet tij, doemos do t’ua ofrojmë dhe dhurojmë edhe të tjerëve, si pasojë e paevitueshme e jetës së krishterë.

Dëshmia e krishterë është si “shtatzënia”, ngjizja e jetës së re, e cila hetohet doemos, së pari te gruaja-nëna, pastaj edhe te të tjerët, sepse është diçka konkrete, reale, e dukshme, ka shenja të jashtme që tregojnë se jeta e re është në zhvillim, në rritje dhe përgatitet për lindje.

Të jemi me Krishtin, të Krishtit, ta kemi atë në jetën tonë, e mos ta hetojmë këtë risi së pari ne, pastaj edhe të tjerët, është e pamundshme, sepse Ai do të na “shtyjë” apo “frymëzojë” për veprim dhe dëshmi në mënyra të llojllojshme dhe jetësore.

“Prania e Zotit – SHEKINAH – në Arkën e Besëlidhjes dhe në Virgjërën Mari ishte për të tjerët, për të gjithë: te Arka e Zotit për të zgjedhurit e Izraelit, tridhjetë mijë vetë (2 Sam 6, 1), te Zonja Mari për mbarë njerëzimin (krh. Lk 1, 43-44).”

ABC-ja bashkëshortore – martesore (III)

PËRGATITI:

P. Shtjefën Dodes SJ

Të jetosh i/e lumtur një jetë të gjatë me një njeri që e do, është gjë e arritshme! Duhet pranuar se këtu duhet pak veprim dhe angazhim. Dashuria në raste shumë të rralla mund të funksionojë vetvetiu – të paktën jo gjithmonë. Edhe pse kjo nuk tingëllon jo edhe aq romantike, ia vlen të investosh pak angazhim në partneritetin tuaj. Me këtë "ABC-ja bashkëshortore – martesore" mund të fitoni në këtë drejtim shumë nxitje.

P - prindëria; Q - qëndrueshmëria; R - Respekti; Rr - rrugëzgjdhjet; S - Sfera intime - private (seksualiteti); Sh - shëndeti; T - teprimi (në edukim);

P - prindëria

Të bëhesh prind e ndryshon partneritetin me themel. Befas njeriu nuk është më vetëm dhe papritmas tash ekziston fjala "nënë" dhe "babë" (mami, babi), sikur dalin në dritë krejt persona të rinj. Dhe këto role të reja në të cilat hyjmë sjellin me vete po ashtu shumë kërkesa dhe detyra të reja. Keni para sysh që mos të harroni që Ju të dytë me gjithë pelenat, lodrat dhe thithat jeni dy njerëz të rritur që duhen. Në të gjitha këto mos e harroni krejt marrëdhënien Tuaj. Thirni njëri-tjetrin edhe më tutje me emër dhe mos e karakterizoni njëri-tjetrin me "mama" apo "babi". Kujdesuni që të keni kohë edhe për vetë ju. Ju nuk jeni vetëm prind.

Q - qëndrueshmëria

Gjithmonë në jetë vijnë edhe kohët e vështira. Disa çifte shkatërrohen në kriza, të tjerat dalin prej tyre edhe më të forta. Ai që qëndron në kohërat e vështira, e forcon partneritetin. Qëndrueshmërinë e gjejmë nëpërmjet përqafimit të fuqishëm, ashtu që tjetri na jep zemër, është afër nesh, na përkrah dhe së bashku i menaxhojmë gjërat.

R - Respekti

Respekti është një prej elementeve kyçe për një marrëdhënie jetëgjatë. Ne do të duhej të respektonim njëri-tjetrin, ashtu siç është, ne do të duhej atë (partnerin apo partneren) ta marrim para sysh dhe ta pranojmë. Ai që nuk ka respekt për tjetrin shpejt anon kah ajo që mos t'i përfillë dhe fillon t'i cenojë nevojat e tjetrit. Respekti për njëri-tjetrin na bën të jemi më të zgjuar dhe më të vëmendshëm dhe jo që thjesht të kapërcejmë nëpër tjetrin. Ai që e merr para sysh tjetrin i qaset vetes mirë dhe krijon kështu një bazë të mirë për të qenët së bashku.

Rr - rrugëzgjdhjet (kontrollimi tremujor; ndarja e punës; këshillimi bashkëshortor)

Një marrëdhënie jetëgjatë bashkëshortore është si një kopsht që kërkon vëmendjen dhe

përkushtimin tonë. Nganjëherë duhet shkullur barin e keq, duhet plehëruar, ujitur, nganjëherë disa lule duhet mbjellë dhe ndoshta të tjerat duhen hedhur. Dhe këtu duhet të jetë te të dy partnerët të përfshirë për të bërë diçka për marrëdhënien. Nëse vetëm njëri e merr rolin e kopshtarit, kjo mund të mos funksionojë.

Meqenëse një marrëdhënie jetëgjatë vetvetiu nuk kalon e lumtur në mënyrë automatike, prej të dyve nga ju kërkohet të bëni diçka në këtë drejtim për të qëndruar bashkë. Të shumtën e rasteve më lehtë ndryshohet diçka, nëse pakënaqësitë apo mosmarrëveshjet njihen herët në mnyrë të mjaftueshme. Për këtë arsye është e përshtatshme në intervale të rregullta të reflektoni bashkërisht se ç' e mirë e ç' jo e mirë po ndodhë në marrëdhënie. Uluni njëherë në çerekun e vitit së bashku dhe flisni për marrëdhënien Tuaj. Shprehuni çfarë po ju kënaq, në ç' gjë jeni të lumtur dhe ç' gjë po ju nervozon apo ku jeni të palumtur. Kujdes: këtu jo të grindeni, por të veproni në drejtim të gjetjes së orientimit për një marrëdhënie të lumtur.

Ndarja tradicionale e punës në mes burrit dhe gruas gjithnjë e më shumë po bëhet pjesë e së kaluarës. Shumë gra ndërkojnë po marrin pozita shoqërore, profesionale. Për këtë arsye ndarja e punës, që ka të bëjë me ekonominë shtëpiake dhe edukatën e fëmijëve, duhet të bëhet drejtësisht. Këtu mund të lindin shumë grindje dhe pakënaqësi nëse njëri prej të dyve nuk e ndjen veten mjaft të përgjegjshëm për këto detyra. Ndani pra drejtë detyrat që ju takojnë ashtu që të dytë të jeni të kënaqur. Nganjëherë ndodhë që çifti bashkëshortor thjesht t'i humb shpresat. Plagët duken shumë të thella, gjendja e bërë lësh, problemi shumë i madh. Para se krejt t'i çoni duart do të duhej të paktën të provoni së bashku të gjeni ndihmë të ndonjë këshillimore familjare. Dashuria Juaj në çdo rast e meriton këtë. Është e vërtetë se shumë prej nesh duhen kaluar përmbi hijet tona personale. Bëjeni këtë - jepni vetes edhe këtë shans.

S - Sfera intime - private (seksualiteti)

Seksualiteti është një mënyrë e mrekullueshme për ta shprehur dashurinë dhe për ta ndarë atë me gjininë tjetër. Përdoreni këtë njëjtë për të dhënë e për të marrë. Shijoni butësinë e kënaqësinë e përbashkët. Mësohuni ta njihni me vigjilencë njëri-tjetrin dhe zbulojeni se me çfarë mund ta gëzoni tjetrin dhe veten.

Nga një partneritet jetëgjatë shpeshherë vjen arrin edhe pika e problemeve seksuale. Qëfti ulet, njëri dëshiron më shpesh se tjetri ose qëfti rritet tepër. Ekziston gjithmonë rreziku i një ngarkese të madhe në jetën e përbashkët seksuale. Veçanërisht kur dy vetë me vite jetojnë bashkë, është normale që vullneti për njëri-tjetrin në disa faza të zvogëlohet. Kjo është në rregull. Problemet në këtë lëmi janë gjithmonë problem i çiftit dhe nuk guxon të hidhen vetëm te njëri. Nëse e keni ndjenjën se problemi Juaj po ju ngarkon shumë, do të duhej të kërkonit ndihmë profesionale. Në disa vende ekzistojnë mundësi të ndryshme këshillimi apo terapi familjare, që mund t'ju ndihmojnë. Keni para sysh të respektoni një sferë të sigurt private. Edhe pse tingëllon si "moderne", që, gjatë kohës, kur njëri i lanë dhëmbët e tjetri është i ulur në tualet, nuk është e thënë që edhe Ju të bëni kështu. Në fillim ndoshta kjo mund të paraqesë njëfarë joshje, mirëpo kjo shpejt vjetrohet. Shpejt ekziston rreziku i të ndërjet "shlirë", por kjo në një kohë të gjatë ndikon krejt ndryshe se është atraktive. Keni para sysh, pra, që çdonjëri të mund ta ruajë sferën e vet private, pavarësisht si e merr këtë tjetri.

Sh - shëndeti

Edhe shëndetin dhe sëmundjen duhet vështuar në kontekstin e marrëdhënieve bazike jetësore, ndër të cilat rol të rëndësishëm kanë edhe marrëdhëniet bashkëshortore. Marrëdhëniet e shëndosha dhe cilësore bashkëshortore zhvillohen dhe mbahen me dialog me njëri-tjetrin, me bisedë për përjetimin e dyanshëm brenda martesës. Ma-

rëdhënia martesore me dialog të dyanshëm duhet vetëdijesuar në atë shkallë, në mënyrë që të ketë çka të punohet në të. Për fat të keq, çiftet bashkëshortore me pavetëdije e kundërshtojnë dialogun e dyanshëm në mënyrë që t'i ikin nevojës dhe domosdoshmërisë së veprimit në të. Cilësia e marrëdhënies dhe dialogut në martesë, e mundëson cilësinë e shëndetit psikik dhe fizik të partnerëve bashkëshortorë. Nëse nuk ka kësi cilësie dhe komunikimi, nuk është kërcënuar vetëm martesa, por edhe shëndeti i çiftit. Është interesante të shihen çiftet që nuk janë mësuar të dialogojnë, që nuk shkon pak kah rënia në konflikt, se si karriera e tyre shkon duke u zbehur, statusi material është i kërcënuar, por i frekuentojnë edhe ambulancat për halle të ndryshme. U bie fuqia ekonomike dhe gjendja shëndetësore. Në punë nuk janë më ajo çfarë kanë qenë.

Martesen duhet ruajtur, jo vetëm për shkak vetëm të fëmijëve, por edhe për shkak të shëndetit psikik dhe fizik personal të çiftit martesor. Për martesë nuk kanë nevojë vetëm fëmijët, por edhe çiftet martesore! Duhet mbrojtur pra edhe për shkak të vetes, se pasi të shkojnë fëmijët, secili në punë të vet, çifti mbetet i vetëm, pranë njëri-tjetrit në atë martesë siç e kanë kultivuar vetë deri atëherë.

T - teprimi (në edukim)

Disa prindër e identifikojnë veten dhe sjelljen e vet si dhe fëmijën dhe sjelljen e tij me shkallën dhe pasojën në nivelin e ndikimit të drejtpërdrejtë. Vetëm veten e konsiderojnë të përgjegjshëm për gjithçka ndodh me fëmijën me bindjen se mund të ndikojnë direkt në zhvillimin e fëmijës, atë ta drejtojnë dhe ta programojnë. Për çdo mospjesë të zhvillimit të fëmijës e fajësojnë veten dhe sjelljen e vet, çka qartë vlen edhe për çdo sukses të fëmijës, që ia përshkruajnë vetes dhe aktiviteteve të veta. Rezultati i kësaj janë kundërshtimet, fajësimet, ankesat e ndërsjella, ndjenja e fajit dhe frustrimit për shkak të pritjeve të paralizuar në planin e edukimit të zhvilli-

mit të fëmijës. Të qenit prindër e identifikojnë me një "punë" që duhet kryer mirë, sipas të gjitha recetave të ekspertëve dhe shkencave bashkëkohore, kurse rezultatet duhet patjetër t'u përshtaten angazhimeve të bëra dhe mjeteve të përdorura. Një prindëri e tillë për ta është shumë e mundimshme dhe zhgënjyese, kurse për fëmijën e dëmshme. Ajo është për jetën jo reale, dhe shpesh pas kësaj fshihet dashuria egoiste dhe posesive prindërore, në të cilën fëmija merret si dekorim i prindërve dhe jo si qenie e pavarur dhe autoktone, që ka të drejtën për zhvillimin personal dhe për një ardhmëri të pavarur nga prindërit.

Prindërit tjerë e pranojnë rrjedhën reale jetësore të dinamikës si në mes veti (si bashkëshortë), por edhe në raport me fëmijën. Vetën dhe fëmijën e konsiderojnë pjesëmarrës të procesit jetësor të përbashkët, të komplikuar dhe të ndërlikuar rrethor, brenda të cilit edhe shkaqet edhe pasojat janë të kushtëzuara dyanshmërisht. Edhe fëmija edhe prindërit janë edhe shkaqe edhe pasoja e asaj çfarë ndodh ndër ta. Qëllimi i prindërve është krijimi i kushteve sa më të volitshme, brenda të cilave mundësohet të ndodhë pa pengesa ky proces rrethor i edukimit dhe zhvillimit të fëmijës. Ata janë të gatshëm t'i pranojnë rezultatet që nuk i presin, pasojat që nuk i kanë shpresuar dhe zhvillimin që nuk e kanë paraparë. Ata nuk e fajësojnë njëri-tjetrin, por bashkëpunojnë, merren vesh dhe mundohen të gjejnë në rrethanat e paparshtueshme të zhvillimit të fëmijës. Së bashku me fëmijën zhvillohen dhe edukohen, dhe nuk i kufizojnë funksionet e tyre prindërore duke e parë veten vetëm si edukatorë aktiv të fëmijës dhe "dirigjentë" të zhvillimit të tij. Një prindëri e tillë është më reale, më pak zhgënjyese, më pak e mundimshme, por edhe më pak e dëmshme për fëmijën dhe për prindërit. Edhe suksesi dhe mospjesëmarrja në të përvetësojnë as nëna as babai, por as nuk mbartet krejt faji te fëmija.

Njeriu materialist dhe vlerat shpirtërore

Ne si animuesit e oratorit "Don Bosko" Prishtinë dhe si nxënës të liceut të Don Boskos, gjatë kampingut të animatorëve, kemi bërë një takim me temën: Auto-realizmi, auto-promovimi, nëpërmjet rrugës së dhurimit të vetvetes të tjerëve dhe shërbimit ndaj të vegjëlve.

Kemi kuptuar që eksitojnë së paku dy projekte të jetës, dy mënyra se si kuptohet dhe jetohej jeta: ajo, e cila themelohet mbi vlerat materiale (njeri materialist) dhe ajo, e cila themelohet në vlerat shpirtërore (njeri shpirtëror).

Për atë, e cila themelohet mbi vlerat materiale, kemi reflektuar kështu: të gjithë ne shohim dhe dëgjojmë këtë: për të qenë i lumtur duhen shumë të holla, kemi nevojë për makina të forta dhe të shtrënjta, luksoze, një jetë VIP, kemi nevojë për një dukje të bukur, për intervenime plastike, kemi nevojë për kënaqësi materiale... etj.

E kështu pra, dëgjojmë dhe shohim njerëz të spektaklit, të sportit, të politikës, të ekonomisë, ... të cilët kanë një shumë të madhe të parave, ku në ndërkohë shumë njerëz të rëndomtë ... vdesin nga uria, vuajnë nga vuajtjet e ndryshme, janë të sëmurë, janë rrugëve të qyteteve...

Për këta lloj njerëzish para të janë gjëja më e rëndësishme e jetës; pra, të kesh një trup të mirë, të jesh i famshëm dhe i fuqishëm është më e rëndësishme se sa gjërat tjera;...! Pra, a doni të jeni të lumtur? Paratë e fituara me lehtësi, me famë dhe kult mbi trupin, shfrytëzim seksi pa asnjë rregull, keqpërdorimi politik pors mundësi pushteti mbi të tjerët. Ky projekt, kjo mënyrë e jetës bazohet në të "mirat materiale".

Pra, a është e vërtetë që lumturia bazohet dhe themelohet në këto gjëra? Këta persona, kur vdesin çka do të marrin me vete në atë botë?

Për këta persona, auto-realizimi identifikohet me auto-lavdërim, që është rezultat i sentimentit të pushtetit, i kënaqësisë, i vëmendjes, i duartrokitjeve, i famës, i suksesit, i pushtetit.

Këto ditë kemi dëgjuar shumë për yllin e rock muzikës Michael Jackson, fama e të cilit ka arritur në kulminacion, por prapëseprapë ai ka vdekur, kështu që e vetmja gjë që është e përfundshme,

është Zoti dhe besimi në të, kjo nuk do të vdesë kurrë.

Tjetër projekt është a, i cili themelohet në vlerat shpirtërore. Çka do të thotë?

Janë shumë të rinj, shumë burra dhe gra, në familjet tona, në vendet tona, në misionet të ndryshme, të cilët besojnë që lumturia e vërtetë nuk gjendet as në pasuri, as në lavdi njerëzore, as në pushtet, dhe as në shkencën, teknikë dhe art, por në vlerat shpirtërore; mbi të gjitha në Zotin, si burim i çdo të mire dhe dashurie.

Këta persona, të cilët bazohen në vlerat shpirtërore, besojnë që personi ekziston për të dashuruar dhe për t'i shërbyer Zotit dhe të afërmit; që dinjiteti dhe auto-realizmi bazohet në të besuarit në Zotin dhe në të afërmin, që qëllimi i jetës njerëzore është të përcaktohen për Zotin dhe për të afërmin, por si përkushtim i vërtetë.

Në qoftë se besoj në Zotin dhe i përkas vetëm Zotit, vet Zoti më liron nga fuqia e gjërave materiale, nga pushteti i pretendimeve dhe aspekti i botës materiale.

Zoti i ka dhuruar njeriut një arsye dhe një vullnet dhe duke i falënderuar për këtë gjë, mund ta zgjedhë të mirën nga e keqja dhe ta orientojë vetën kah e mira, e cila është: të bëjë atë që Zoti dëshiron nga ai!

Këta persona flasin dhe deklarojnë auto-promovimin dhe auto-realizimin, si rezultat nga i cili shprehet, që e ndiejnë mirë vetën me të tjerët.

Në fund të këtij takimi kemi bërë këtë pyetje:

Cilat janë ato ndjenja, apo qëndrime dhe sjellje negative, të cilat një i ri i moshës sonë duhet t'i largojë nga vetja për të jetuar projektin e jetës, i cili bazohet në Zotin dhe në vlerat shpirtërore?

Ne si animatorë jemi përgjigjur kështu: "Në ditët e sotme duhet më shumë punë me të rinjtë. Është e vështirë t'i kuptojmë gjërat se si rrjedhin apo ku e kanë kuptimin e vërtetë, por ne si të rinj që mendojmë mirë dhe dëshirojmë t'i realizojmë projektet tona të jetës me sukses, mund t'i ndihmojmë bashkëmoshatarëve tanë duke i bindur se çka është e mirë dhe çka tjera, duke besuar në atë person që ai të fitojë vetëbesim. Por çdo njeri gabon, dhe gjatë tërë jetës gabimet



“ Zoti i ka dhuruar njeriut një arsye dhe një vullnet dhe duke i falënderuar për këtë gjë, mund ta zgjedhë të mirën nga e keqja dhe ta orientojë vetën kah e mira, e cila është: të bëjë atë që Zoti dëshiron nga ai! ”

janë të pashmangshme.

Për të jetuar në projektin, i cili bazohet në Zotin dhe në vlerat shpirtërore, nënkuptojmë të jetuarit në harmoni me rrethin, duke qenë në gjendje të grumbullojmë gjëra të mira dhe në anën tjetër duke larguar veset e këqija si dhe duke krijuar një personalitet auto-realizues në përpunshmëri me realen apo të vërtetën. Kemi dashur që ta cekim si faktor të parë Moralën – të jemi të ndershëm është gjëja e parë që ne duhet të kemi, sepse pa të nuk mund të jetojmë një jetë reale, të pastër dhe njerëzore. Të largohemi nga gjërat negative, sepse Zoti nuk thotë se ne duhet të bëhemi rob i pluhurit të bardhë, Zoti nuk thotë se duhet të kemi jetë të crregullt të natës, të dalim, të dehemi, dhe të kthehemi në shtëpi në orët e para të mëngjesit, Zoti nuk thotë se

në këtë jetë duhet të varem nga cigarja, të kemi xheloz, lakmi, egoizëm e shumë gjëra të tjera negative që nuk sjellin pozitivitet, veç shkatërrim të shëndetit dhe jetës sonë.

E përfundojmë me një porosi që mendojmë që sado pak të vetëdijesohemi për të ardhmen, ta duam krijuesin tonë, Zotin, dhe gjërat që ai ka urdhëruar që ne t'i zbatojmë në këtë botë, në mënyrë që të kemi një jetë sa më normale dhe njerëzore.

Në përfundimin e këtij takimi, ne kemi kuptuar që jo të gjithë mendojmë në të njëjtën mënyrë, jo të gjithë do të përjetojmë përvoja të njëjta dhe jo të gjithë të rinjtë dhe njerëzit tjerë e themelojnë jetën në vlera të njëjta.

Kemi kuptuar që të gjithë jemi në përmbljedhje dhe ndërtim të jetës sonë, në formim të vazhdueshëm, çdo ditë jemi të

thirrur të rifillojmë për të qenë ata që ende nuk jemi në plotësi.

Njeriu nuk është i formuar që në fillim, por ai do të zhvillohet ndërkohë. Çdo person, kur të lindë, ka menjëherë në rrethin e vet elementet e të qenurit njeri, por duhet të zhvillohet.

Projekti ynë i jetës duhet të jetë rezultat i dëshirave tona dhe të zgjedhjeve tona, të cilat duhet t'i realizojmë çdo ditë gjatë gjithë jetës sonë.

Sot jemi të lumtur, sepse jetën e shohim me besim, me mendim kritik, të qetë dhe me zemër të pastër.

Artikulli është shkruar nga animatorët e oratorit dhe nxënësit e liceut "Don Bosko" të Prishtinës.

Një letër dashurie

Për ditëlindje një princeshë mori prej të fejuarit të saj një kuti shumë të rëndë dhe të një forme të çuditshme.

E padurueshme nga kureshtja, e hapi dhe gjeti ... një gjyle topi. E dëshiruar dhe e tërbuar nga hidhërimi, e hodhi për tokë gjylen e zezë të bronzit.

Kur ra në tokë, mbuloja e jashtme u hap e prej saj doli një top argjendi më i vogël. Prince-sha e kapi menjëherë. Duke e sjellë nëpër duar, e shtypi lehtë mbi sipërfaqe. Sfera e argjendit u hap dhe prej saj doli një kuti me mbështjellëse të artë.

Kësaj radhe princesha e hapi kutinë me shumë lehtësi. Brenda, mbi një shtresë të butë kadi-feje të zezë, ndriçonte një unazë e mbushur plot me xhevahire të shkëlqyeshëm, të cilët së bashku formonin dy fjalë të thjeshta: **TË DUA.**

Shumë gjëra, që në shikim të parë na duken të vështira e të pakuptueshme, fshehin në brendësinë e tyre visare shumë të çmueshme.

Kur e marrim Biblën në dorë, në fillim na duket si një gjyle topi e madhe dhe e rëndë, e formuar jo prej bronzit, por prej letre. Nevojitet që të kërkojmë me kujdes visarin që fsheh brenda.

Në fund, me siguri do të mbesim të befazuar me porosinë e saj: **ZOTI TË DO.**

Mësimi mbi lutjen

Një ditë Jezusi po lutej diku në një vend. Kur e kreu lutjen, i tha njëri prej nxënësve: “Zotëri, na mëso edhe ne të lute-mi, siç i mësoi edhe Gjoni nxënësit e vet.”

“Kur të luteni u tha Jezusi thoni:

O Atë!

U shenjtëroftë Emri yt!

Ardhtë Mbretëria jote!

Na jep çdo ditë bukën tonë të përditshme!

Na i fal mëkatet tona, sepse edhe ne i falim fajtorët tanë.

E mos lejo të biem në tundim!”



Çka Krishti u ka thënë ende apostujve të vet, zbulojë në fjalëkryqin e zbrazët, në mënyrë që në katorrin e zbrazët vendosi saktë 12 katorrët e vegjël!

Q	E	D	H	E	T	S	P	O
J	U	T	H	E	M	O	L	P
E	D	O	T	J	U	H	K	E

K	O	N	U	N	K	E	O	T
N	I	L	L	G	J	E	K	I
D	O	T	J	E	P	N	I	E

I	E	D	E	P	S	E	K	U
T	R	O	P	M	E	R	R	K
J	U	C	R	K	O	N	G	J

(Lk, 11, 1-13)

Simoni – Pjetër, kryetar i Kishës

Apostujt ishin duke peshkuar në liqenin e Gjenezaretit. Nuk kishin zënë asgjë. Atëherë u dëftua Jezusi dhe u tha t'i qesin rrjetat përsëri. Si i qitën, rrjetat u mbushën me peshk. Apostujt dolën në tokë dhe hëngrën peshk



me Jezusin. Jezusi duke iu drejtuar tri herë Simonit – Pjetër, e pyeti:

“Simon – Pjetër, biri i Gjonit, a më do ti më fort se këta”

Pjetri u përgjigj:

“Po. Zotëri, unë të dua!”

“Mirë, pra, kulloti qengjat e mi! – i tha Jezusi. Po kështu e pyeti edhe të dytën herë e Pjetri i përgjigj po në të njëjtën mënyrë si më parë. Mirëpo, kur e pyeti të tretën herë, Pjetri përgjigj si më parë, por i përmalluar shumë, ia filloi të qajë; Krishti i tha:

“Kulloti delet e mia!”

Kështu Jezusi e bëri Pjetrin kryetarin e Kishës.

Kryetari i Kishës quhet **papë**.


Kryetari i parë ishte **shën**

Pjetri.

Papa i sotshëm është **Benedikti XVI**.

Katër figura me katër ndryshime

Në figurat nr. 2, 3, dhe 4, zbuloji shpejt katër dallime të vogla në krahasim me figurën e parë!



Të mëdhenjtë për Hyjin dhe besimin

Albert Einstein

“Për sa më përket mua, jam shumë i bindur se njerëzimi pa besim edhe sot do të gjendej në gjendje barbare. E tërë jeta do të zhvillohej në rrethana primitive të pasqyreshme.”


Nuk do të kishte siguri as për jetë, as për pronë, do të ishte luftë e të gjithëve kundër të gjithëve, që është tendencë e përbashkët e njeriut...”

Kështu shkruante për besimin Albert Einsteinin. Këtë vit janë mbushur 130 vjet nga lindja e këtij gjeniu të madh të njerëzimit. Einsteinin u lind pikërisht në mesditë me 14 mars 1879. Kjo ngjau në qytetin e vogël gjerman Ulm, në kohën kur nga kambanarët e kishës kumbuan nga kambanat. Nga Ulmi prindërit e tij u shpërngulën në München.

Alberti, të cilin nga dashuria e qanin Albi, u mësuua që në fëmijërinë e hershme t'i binte violinës.

Violina, e më pas matematika e fizika, gjithnjë e më tepër e preokuponin vëmendjen e Einsteinit të ri. Në gjimnaz kjo dashuri zhvillohej gjithnjë e më tepër, por gjuhët e huaja i shkollonin më vështirë.

Me gjashtëmbëdhjetë vjet Albertit të ri iu desh ta lëshojë qytetin e dashur dhe të shkojë të studiojë në Zvicër. Më vonë u zhvendos në Berlin, por së shpejti



ti, për shkak të Luftës së Dytë Botërore, e lëshoi Gjermaninë dhe shkoi në Amerikë.

Shkencëtarit të madh i pëlqenin udhëtimet. Ai i kaloi shumë shtete. Ishte në Holandë, në Austri, Angli, Spanjë, në Çekosllovakinë e atëherëshme, në Kinë, Indi, Japan... Kudo që të shkonte i jepnin mirënjohje të mëdha. Kështu, në Japoni e kishte mirëpritur vetë mbretëresha, gjë që

ishte ngjarje e jashtëzakonshme.

Einsteinin në mënyrë të posaçme e donte muzikën dhe gjithmonë me kënaqësi e merrte në dorë violinën e tij. Kompozitorët që i pëlqenin më së shumti ishin: Mozarti, Bachu dhe mjeshtrit e moçëm italianë.

Në vitin 1921 Albert Einsteinin e mori çmimin Nobel për fizikë. Ai punoi palodhshëm deri në vdekje në Princeton (SHBA), me 18 prill 1955.

Për këtë shkencëtar të madh, për veprën dhe teorinë e tij, posaçërisht për teorinë e relativitetit, e cila e ka bërë atë famshëm dhe të popullarizuar, do të mësoni akoma në shkollë. Teoria e tij e mundësoi përdorimin e atomit, shpikjen e kompjuterit, etj... Por në dijen tuaj dhe në kujtesën tuaj mbi A. Einsteinin vendosni edhe fjalët e tij për Hyjin dhe besimin: “Religjioni i ka ndihmuar përpërkimit të njerëzimit në të gjitha aspektet”.

BARCOLETA

Drejtori

Në një klasë, gjatë orës së mësimi, dëgjohej vetëm zhurmë. I nervozuar hyri drejtori në klasë, kapi për krahu njërin që ishte më i madh, e nxori nga ora e mësimi dhe e flaku jashtë shkolle.

Mbretëroi një qetësi.

“Kështu e donë veshët e mi”.

Tha Drejtori.

Pas një gjysmë ore, hynë në drejtori ka nxënës dhe iu lutën Drejtorit: “Të lutemi, z. drejtor, kthena mësuesin përsëri.”

Dy sheikë

Dy sheikë të pasur bisedonin rreth artit.

“Më fascinon Pikasso”, tha njëri.

“Pse?” pyeti tjetri.

“Sepse asnjëri në botë nuk ka mundur ta shesë vajin më shtrenjtë se ai.”

Kristofor Kolumbo

Në dërrasën e zezë shkruan mësuesja:

– “Kristofor Kolumbo 1451-1506.”

Pastaj e pyet Dritën se çka do të thotë kjo.

Drita: “Po, numri i telefonit të Kristofor Kolumbos”

Referat

Në një orë mësimi nxënësit shkruanin një referat me temën “Po të isha shef i një ndërmarreje të madhe”, por Gjoni nuk shkruante, i kishte lidhur duart dhe shikonte pandërprerë në dritare.

Iu afrua mësuesja dhe e pyeti: “Gjon, pse nuk shkruan?”

“Ah, jam duke e pritur sekretarëshin time” ia ktheu Gjoni.

(Driton Nikollibaj)



Ti që e do Nënë Terezën dhe ndërtimin e Katedrales, uroje, ndihmoje, realizoje, duke thirrur në numrin

0900-901-101

Çdo thirrje e jote të kushton një euro.

**TA NDIHMOJMË
NDËRTIMIN E KATEDRALES**

*Jam mik i Kishës Katolike
dhe dua ta ndihmoj
ndërtimin e Katedrales
"Nëna Terezë" në Prishtinë!*

Gjithë juve miq dhe bamirës
të dashur, ju mundësojmë ta
jepni kontributin përmes
xhirollogarive bankare.

Faleminderit!

X Raiffeisen BANK
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:
EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

ABONONI "DRITËN"

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë "Drita". Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë** "Dritën" (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë: **Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.**

Emri: _____
Mbiemri: _____
Adresa: _____
Qyteti: _____
Kodi postar: _____
Numri i telefonit: _____
E-mail: _____

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.

DRITA
"Drita hulumt kundër urrejtës kur ndihet."
KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE
Prizren • Maj 2009 • Viti XXV • Nr. 3 (25) • Qindisi: Rreth 10,000 • Zëritë 100,000 • DITA 11.10

Fëmija
- sfida jete dhe dashurie

Nëna Tereza

Pali është misionari më i dalluar i Krishtit në historinë e njerëzimit

Masakra e Majës dhe Krenicës i ka dritaret sy të nënave që presin t'u kthehen të vdekurit për ta pajtuar dhembjen